



NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE 27 nëntor- 18 dhjetor 2006

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

1. Gjatë periudhës 27 nëntor – 18 dhjetor 2006 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar gjithsej 7 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Në 7 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 364 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 69 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuara nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjet e komisionit kanë qenë të pranishëm jo vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projek-

(Vijon në faqen 2)

RASTE VËZHGIMI Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

Projektligji "Për Akademinë e Shkencave"

Projektligji "Për Akademinë e Shkencave" është depozituar në Kuvend më datë 6.09.2006 dhe është përfshirë në programin e punimeve të Kuvendit më datë 6.11.2006. Ky projektligj është paraqitur në Kuvend me iniciativë të Qeverisë. Është parashikuar që të shqyrtohet në kalendarin 3-javor të periudhës 25 shtator - 16 tetor dhe në të gjitha kalendarët në vijim duke përfshirë edhe kalendarin e periudhës 17 nëntor – 18 dhjetor 2006.

Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji është Komisioni për Edukimin dhe Mjetet

(Vijon në faqen 4)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Monitorimi i Veprimtarisë së Komisioneve Parlamentare për periudhën 27 nëntor - 18 dhjetor 2006

faqe 1-4

2. Raste vëzhgimi: Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

faqe 4-5

3. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin dhjetor 2006

faqe 6-7

4. Projektligje në proces Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

faqe 8-37

5. Kalendar 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë 18-31 dhjetor 2006

faqe 1

K A L E N D A R I

i Punimeve të Kuvendit Sesionit të III-të, Legjislatura e XVII-të

E Mërkurë, datë 27.12.2006, ora 10.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 18.12.2006.
3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006 për Shqipërinë".
4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, 1998".
5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8551 datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e shtetit".

PËR RIVOTIM:

1. Projektligji "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar".

PËR VOTIM:

1. Projektligji "Për dhënie amnistie".

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

27 nëntor -18 dhjetor 2006

(Vijon nga faqja 1)

tligjeve përkatëse por edhe përfaqësues të grupeve të interesit. Në mbledhjen e datës 12.12.2006 kur është shqyrtuar projektligji "Për Bankat" në mbledhje kanë qenë të ftuar edhe përfaqësues të Shoqatës së Bankave, ndërsa gjatë shqyrtimit të projektligjit "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", nismë e 20.000 zgjedhësve ka pasur një pjesëmarrje të madhe të grupeve të interesit dhe organizatave ndërkombëtare si: ZMQ, OSCE, USAID etj.

3. Edhe gjatë këtyre tre javëve është konstatuar se deputetët nuk janë të informuar paraprakisht për projektligjet me objekt ratifikim marrëveshjes ndërkombëtare dhe nuk kërkojnë informacion për detyrimet që rrjedhin nga ky dokument. Në 7 mbledhje të realizuara numërohen rreth 42 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Mesatarisht në secilën mbledhje janë zhvilluar 6 diskutime kryesisht nga të njëjtët deputetë. Gjithashtu janë propozuar 6 amendamente gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme.

4. Gjatë kësaj periudhe, si në periudhat e mëparshme, janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve. Gjithashtu deputetët vazhdojnë të vijnë me vonesë në mbledhje dhe si rrjedhojë edhe mbledhjet fillojnë me vonesë. Mesatarisht mungojnë 5 deputetë për mbledhje nga 19 që ka komisioni. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

5. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Siç rezulton nga monitorimi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka një pjesëmarrje të rregullt të deputeteve në mbledhjet e komisionit. Deputetët vijnë me vonesë dhe largohen përpara mbylljes së mbledhjes. Gjatë këtyre tre javëve në ndryshim me periudhat e mëparshme nuk ka pasur raste të firmosjes së prezencës nga deputetët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje. Përsa i përket pjesëmarrjes në diskutime dhe informimit paraprak të deputetëve për projektligjet, edhe gjatë kësaj periudhe është konstatuar se deputetët informohen paraprakisht vetëm për projektligjet e rëndësishme. Gjatë këtyre 3 javëve janë zhvilluar më pak mbledhje se në kalendarin e kaluar dhe ka një ulje të kohëzgjatjes së mbledhjeve. Gjatë kësaj periudhe në ndryshim nga periudhat e tjera në mbledhjet e komisionit përveç ekspertëve të qeverisë kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të grupeve të interesit.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

1. Gjatë periudhës 27 nëntor – 18 dhjetor 2006 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka zhvilluar gjithsej 8 mbledhje. Në përgjithësi mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar dhe janë zhvilluar të gjitha sipas parashikimit duke përjashtuar vetëm mbledhjen e datës 15.12.2006 e cila nuk ka qenë e parashikuar

në kalendar. Në këtë mbledhje e cila është zhvilluar në godinën e seancave plenare komisioni ka miratuar projektligjin "Për koncesionet". Nuk është zhvilluar asnjë mbledhje tjetër me objekt shqyrtimin e këtij projektligji duke e kaluar atë në një mbledhje të vetme. Mbledhjet e zhvilluara gjatë këtyre tre javëve kanë pasur për objekt diskutimi projektligje të ndryshme, disa prej të cilëve nuk kanë qenë të parashikuara në kalendar. Kohëzgjatja mesatare e mbledhjeve të monitoruara është 45 minuta. Gjatë këtyre tre javëve janë zhvilluar gjithsej 356 minuta punë efektive në komision. Krahasuar me kalendarin e kaluar kjo shifër vlerësohet të jetë sa 1/3 por është e përafërt me kohëzgjatjen e punimeve të kalendareve të tjera.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm përfaqësues të Këshillit të Ministrave. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë ose burim tjetër, gjatë mbledhjeve të zhvilluara. Në mbledhjet e zhvilluara ka pasur debate dhe diskutime, kryesisht, nga deputetët më aktiv. Në 8 mbledhje të realizuara numërohen rreth 40 diskutime dhe pyetje nga deputetët. Gjithashtu është propozuar vetëm 1 amendament.

3. Gjatë punimeve të këtij kalendar janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje. Mungojnë mesatarisht 5 deputetë për mbledhje nga 17 që ka komisioni. Problem i vazhdueshëm mbetet lëvizja e shpeshtë e deputetëve gjatë kohës së zhvillimit të mbledhjeve. Në disa raste për shkak të këtyre lëvizjeve nuk plotësohet as kuorumi për marrjen e vendimeve. Më datë 13.12.06 pas shumë debatesh opozita është larguar nga mbledhja e komisionit. Për shkak të mosplotësisimit të kuorumit mbledhja është mbyllur. Në mbledhjen e datës 6.12.06 komisioni ka miratuar një projektligj me objekt ratifikimin e një marrëveshje financiare vetëm më 8 deputetë të pranishëm pa u plotësuar kuorumi i kërkuar. Më datë 11.12.06 përfaqësuesit e opozitës janë larguar nga mbledhja, por këtë rradhë me argumentin e zhvillimit të mbledhjes së grupit parlamentar.

4. Gjatë kësaj periudhe më datë 5.12.2006 komisioni ka zhvilluar një seancë dëgjimore në bashkëpunim me ZMN-në. Nuk është zhvilluar asnjë veprimtari të tjetër kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

5. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Gjatë punimeve të këtij kalendar krahasuar me kalendarin e kaluar ka një rënie të ndjeshme të kohëzgjatjes së mbledhjeve kjo edhe për faktin se komisioni gjatë muajit të kaluar ka shqyrtuar projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007".

(vijon në faqen 3)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

27 nëntor - 18 dhjetor 2006

(Vijon nga faqja 2)

Megjithatë debatet, diskutimet si dhe amendamentet janë bërë përsëri nga të njëjtët deputetë, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve vazhdojnë të qëndrojnë pasiv ose mjaftohen vetëm me pyetje informuese. Edhe gjatë kësaj periudhe debatet kanë qenë shumë të ashpra. Përfaqësuesit e opozitës disa herë kanë kërkuar sh-tyrjen e mbledhjeve dhe ka patur raste të largimit të tyre nga mbledhja. Është konstatuar se përsëri de-putetët mbështeten vetëm në burimin e informacion-it të qeverisë. Edhe gjatë kësaj periudhe nuk konsta-tohet një pjesëmarrje dhe përfshirje e grupeve të in-teresit në diskutimin e projektligjeve (me përjashtim të një rasti).

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e In-formimit Publik.

1. Gjatë periudhës 27 nëntor – 18 dhjetor 2006 Ko-misioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Kohëzgjatja mesatare e mbledhjeve të zhvilluara ka qenë 50 minuta. Gjithsej janë zhvilluar 200 minuta punë efektive në komision.

2. Edhe gjatë kësaj periudhe gjatë shqyrtimit të pro-jektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qever-isë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Është ko-statuar se vetëm një pjesë e deputetëve që janë edhe më aktiv kanë informacion praraprak për projektlig-jet objekt diskutimi. Në 4 mbledhje të realizuara numërohen rreth 16 diskutime, por nuk janë propo-zuar amendamente.

3. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve. Në 4 mbledhjet e zhvilluara kanë qenë prezent mesatarisht 9 deputetë nga 15 që ka komisioni.

4. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë se-ancë dëgjimore apo ndonjë veprimtari tjetër kontrol-luese e komisionit.

Disa vlerësime: Në përgjithësi edhe në këtë komision konstatohet se deputetët gjatë shqyrtimit të projek-tligjeve mbështeten kryesisht vetëm në ekspertizën e qeverisë dhe relacionin e projektligjeve. Në 4 mbledh-jet e zhvilluara nuk kanë marrë pjesë përfaqësues të grupeve të interesit. Edhe gjatë kësaj periudhe krahasuar edhe me komisionet e tjera të monitoruara janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

1. Gjatë periudhës 27 nëntor – 18 dhjetor 2006 Ko-misioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Objekti i mbledhjeve ka qenë i parashikuar dhe nuk është ndry-

shuar. Në 6 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 180 minu-ta punë efektive në komision ose mesatarisht 30 minu-ta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqë-sues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve për-katëse. Në 6 mbledhje të realizuara numërohen 18 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Diskutimet kanë të bëjnë kryesisht me deklarime të deputetëve dhe opinione rreth projektligjeve të diskutuara. Një pjesë e madhe e deputetëve që në disa raste e kalon gjysmën nuk kanë informacion praraprak për projek-tligjet e diskutuara. Një pjesë e këtyre deputetëve kanë marrë pjesë në diskutime por qëndrimet e tyre kanë qenë kryesisht politike. Gjithashtu janë propozuar 3 amendamente të cilat kanë qenë të natyrës teknike.

3. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje. Në një rast mbledhja është zhvilluar pa u plotësuar kuorumi i kërkuar. Deputetët vazhdojnë të vijnë me vonesë dhe të largohen pa mbaruar mbledhja. Numri i deputetëve të pranishëm në mbledhje nuk përputhet me numrin e deputetëve të pasqyruar në listëprezencë.

4. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media. Nuk ka pasur pengesa për të marrë pjesë në mbledhje. Gjatë punimeve të këtij kaledari nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore.

Disa vlerësime: Gjatë kësaj periudhe është konstatu-ar se në asnjë mbledhje nuk kanë marrë pjesë për-faqësues të grupit të interesit. Edhe gjatë kësaj peri-udhe në këtë komision janë konstatuar mungesa të deputetëve që në disa raste krijojnë vështirësi në plotësimin e kuorumit. Krahasuar me tre javët e kalu-ara konstatohet një pjesëmarrje më e vogël e de-putetëve në diskutime dhe debate. Janë zhvilluar më pak diskutime dhe deputetët kanë qenë më pak të in-formuar. Gjithashtu edhe kohëzgjatja e mbledhjeve të komisionit ka qenë më e vogël krahasuar me mua-jin nëntor.

Disa vlerësime të përgjithshme për komisionet e mon-itoruara: Krahasuar me punimet e Kuvendit të zhvil-luara gjatë muajit nëntor në të gjitha komisionet e monitoruara është konstatuar një rënie e numrit të mbledhjeve si dhe të kohëzgjatjes së tyre. Duhet thek-suar se gjatë muajit nëntor, krahas projektligjeve të tjera të gjitha komisionet kanë pasur për objekt dis-kutimi projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”.

Gjatë zhvillimit të këtyre mbledhjeve ka pasur shumë diskutime dhe debate, por kryesisht nga deputetët më aktiv. Në disa raste opozita është larguar nga

(vijon në faqen 4)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

27 nëntor - 18 dhjetor 2006

(Vijon nga faqja 3)

mbledhjet e komisioneve në shenjë proteste. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar një pjesëmarrje më e vogël e deputetëve në diskutime. Me përjashtim të Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në të gjitha komisionet e tjera të monitoruara është konstatuar se shumica e deputetëve nuk kanë qenë të informuar paraprakisht për projektligjet e shqyrtuara. Edhe gjatë kësaj periudhe deputetët nuk rezultojnë që të kenë informacion paraprak për projektligjet me objekt ratifikim marrëveshesh ndërkombëtare. Ky fakt konstatohet në mënyrën e kalimit të tyre pa pyetje dhe pa zhvilluar asnjë debat.

Edhe gjatë këtyre tre javëve ashtu si edhe në periudhat e mëparshme të pranishëm në mbledhjet e komisionit kanë qenë kryesisht vetëm përfaqësuesit e qeverisë. Me përjashtim të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në komisionet e tjera nuk kanë marrë pjesë grupet e interesit. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Një interes të veçantë gjatë këtyre tri javëve ka treguar edhe media. Gjatë monitorimit të punimeve të këtij kalendari janë konstatuar përsëri mungesa të shumta të deputetëve si dhe raste kur deputetët vijnë me vonesë dhe largohen pa përfunduar mbledhja.

Janë konstatuar përsëri raste kur mbledhja fillon pa u plotësuar kuorumi siç është edhe rasti i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në mbledhjen e datës 6.12.06 i cili ka miratuar një projektligj me objekt ratifikimin e një marrëveshje financiare vetëm më 8 deputetë të pranishëm pa u plotësuar kuorumi i kërkuar. Shqyrtimi i projektligjit "Për koncesionet" vetëm në një mbledhje komisioni vë në diskutim analizën e zhvilluar të këtij projektligji, i cili vlerësohet me rëndësi të veçantë për ekonominë dhe procesin e integritetit. Gjithashtu, edhe ekspertiza dhe informacioni i shfrytëzuar (vetëm ekspertët e qeverisë) vlerësohet e pamjaftueshme për një shqyrtim të plotë dhe për marrjen e vendimeve të duhura.

*Lindita Troka
Florjan Kalaja
Klesta Hysi
Ermal Markaj*

RASTE VËZHGIMI: PROCESI I SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE TË VEÇANTA

(Vijon nga faqja 1)

e Informimit Publik. Për këtë projektligj nuk kanë dhënë mendim komisionet e tjera.

Për këtë projektligj Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar gjithsej 2 mbledhje përkatësisht më datë 24.10.2006 (senacë dëgjimore) dhe 1.12.2006 me një kohëzgjatje në total prej 160 minutash. Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në mbledhjet e komisionit kanë marrë pjesë ekspertët të qeverisë si dhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave. Komisioni pas dëgjimit të përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave nuk e ka miratuar projektligjin në parim duke votuar 6 vota kundër dhe 4 pro.

Sipas raportit të përgatitur nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik fillimisht komisioni organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit kryesorë të Akademisë së Shkencave. Pas zhvillimit të kësaj seance komisioni vlerësoi se: Projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky projektligj është në vijim të përmirësimeve të njëpasnjëshme që ka ndërmarrë qeveria në fushën e arsimit, kulturës dhe shkencës, duke synuar realizimin e programit të saj. Qëllimi kryesor i këtij programi është ndërtimi i një sistemi modern të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, duke zhvilluar dhe modernizuar sistemin e arsimit të lartë e shkencës e rritur në mënyrë të ndjeshme nivelin e arsimit e kërkimit shkencor si një rrugë prioritare që i paraprin integritetit të vendit në BE. Projektligji fokusohet në përgatitjen e bazës ligjore për reformimin e Akademisë së Shkencave, në përputhje me rekomandimet e studimit të grupit të ekspertëve deri në përfundimet e nxjerra nga diskutimet publike. Sipas këtij raporti veç të tjerave janë bërë përmirësime edhe në këto fusha: Integrimi institucional dhe administrativ i instituteve kërkimore të Akademisë së Shkencave në sistemin e arsimit të lartë përmes krijimit të tri qendrave kërkimore ndërdisiplinore:

- Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike;
- Qendra kërkimore Universitare e Ujit, Energjisë dhe Mjedisit, pranë Univesitetit Politeknik të Tiranës (UPT);
- Qendra Kërkimore Universitare e Gjeoshkencave, pranë UPT-së si dhe dy fakulteteve të reja (Fakulteti i Teknologjisë së informacionit dhe Komunikimit si dhe Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit).

(vijon në faqen 5)

RASTE VËZHGIMI: PROCESI I SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE TË VEÇANTA

(Vijon nga faqja 4)

Akademia mbetet institucion shkencor që vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh. Ajo nuk ka institute kërkimore në përbërje të saj. Akademia e zhvillon veprimtarinë në kuadër të seksioneve.

Sipas këtij raporti funksionet kryesore të Akademisë së Shkencave do të jenë: Bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe mësimore brenda e jashtë vendit, kryerja e studimeve ndërdisiplinore, propozimi i fushave të reja në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit, botimi i organeve periodike dhe veprave të tjera me karakter shkencor, organizimi i kongreseve dhe konferencave të nivelit të lartë shkencor si për shkencat albanologjike ashtu dhe shkencat natyrore e teknike të saj.

Deputetët e shumicës duke gjetur të justifikuar propozimet e bëra në projektligjin "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", u shprehën dakort me përmbajtjen e tij sipas projektit të propozuar nga Këshilli i ministrave, duke qenë dakort për miratimin e tij në seancë plenare.

Mendimi i pakicës

Mendimi i pakicës është se reforma e pretenduar nga projektligji i propozuar prish një sistem të certifikuar të kërkimit shkencor të bazuar në Akademinë e Shkencave, pa ofruar një sistem të ri alternativ, përveç ideve konfuze të huazuara andej-këndej nga hartuesit e saj. Është zbatuar një metodologji krejtësisht e gabuar vlerësimi nga grupi i ekspertëve, i cili është bazuar në vlerësimin e performancës së instituteve shkencore, pa bërë dallim midis instituteve të Akademisë dhe atyre në varësi të dikastereve të ndryshme. Vlerësimi është bazuar vetëm në dy vjetët e fundit, në një kohë që bëhet fjalë për të bërë një institucion prestigjioz dhe elitare, që vepron prej gati 35 vjetësh.

Është mënjanuar dhe injoruar çdo lloj bashkëpunimi me vetë Akademinë e Shkencave, ndërkohë që në grupin e ekspertëve nuk u përfshi asnjë përfaqësues i saj. Akoma më keq anëtarët e këtij grupi nuk i përkasin fushave studimore që mbulohen nga Institutet e Akademisë së Shkencave. Mjaft prej tyre janë dalluar më shumë për CV-në e tyre politike, sesa për atë shkencore.

Sipas mendimit tonë, atashimi i instituteve të Akademisë së Shkencave në departamentet e universitetit në kushtet e sotme, do ta dëmtonte kërkimin shkencor në mënyrë të pariparueshme. Së pari për arsye se disa drejtime studimesh tepër të rëndësishme e specifike, si Sismologjia, Meteorologjia, Etnografia, Fizika Nukleare etj., ose nuk ekzistojnë si

lëndë në universitetet tona, ose trajtohen aty në një nivel fare embrional e informues. Vështirë se ky realitet të nxisë kërkimin shkencor në këto disiplina. Përkundrazi ai do të sjellë zbehjen e deri shuarjen e tyre. Nga ana tjetër, universitetet tona nuk janë të përgatitura për të absorbuar si pjesë të tyre institutet e Akademisë së Shkencave. Pretendimi që reforma synon shkrirjen e procesit mësimor me atë kërkimor, mbetet thjesht një fjalë e bukur, përderisa nuk është bërë asgjë nga qeveria për të krijuar kushtet materiale, hapësirat mjedisore e kohore, për të realizuar këtë integrim. Për këtë mjafton të shihen kushtet e emergjencës që ekzistojnë sot në të gjitha universitetet tona, apo fondet krejt të pamjaftueshme, të buxhetit të shtetit për kërkimin shkencor në vitin 2007.

Prishja e sistemit të kërkimit shkencor, të bazuar në Akademinë e Shkencave, veç të tjerave, do të ndikojë negativisht edhe në bashkëpunimin në fushën e shkencës me një sërë vendesh, sidomos me ato të rajonit të bazuara gjithashtu në sistemet akademike, me të cilat ekziston një traditë shumë e mirë dhe e frytshme në veprimtaritë shkencore.

Në vlerësim të argumentave të mësipërm, deputetët e pakicës gjykojnë se reforma e konceptuar nga qeveria për Akademinë e Shkencave, jo vetëm nuk i ndihmon fuqizimit të punës kërkimore-shkencore, por rrezikon të çbëjë edhe strukturat e konsoliduara të kërkimit shkencor, siç është sistemi i Akademisë së Shkencave.

Si burim informacioni gjatë shqyrtimit të këtij projektligji kanë shërbyer ekspertiza e përfaqësuesve të qeverisë, si dhe mendimet dhe sugjerimet e bëra nga grupet e interesit të përfaqësuar nga Akademia e Shkencave. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nuk janë bërë amendamente.

Projektligji është shqyrtuar në një seancë plenare përkatësisht më datë 11.12.2006. Kohëzgjatja e shqyrtimit të këtij projektligji në seancë plenare ka qenë vetëm 5 minuata. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në seancë nuk ka patur debate. Opozita nuk ka qenë e pranishme. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik si komision përgjegjës ka prezantuar dy raporte në seancë plenare të cilat nuk janë diskutuar për shkak të mungesës së opozitës.

Projektligji u miratua me 75 vota pro, 2 kundër dhe 3 abstenime. Duhet theksuar se në planinin e punës dhe në kalendarin e punimeve të Kuvendit është parashikuar që ky projektligj të kalonte në seancë plenare që më datë 9.10.2006 dhe ka vazhduar të jetë në kalendar edhe për datat 6.11.06; 4.12.06; 7.12.06 dhe është miratuar vetëm në seancën e datës 11.12.2006.

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN NËNTOR 2006

1. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 6.12.2006

VENDIME për propozim projektligjesh

1. Për Propozimin e projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar"

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 6.12.2006

1. Projektligj për disa shtesa në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar

2. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve.

3. Për miratimin e listës paraprake të pronave ta paluajtëshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë Berat, të qarkut të Beratit.

4. Për miratimin e listës paraprake të pronave ta paluajtëshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, komunës Cukalat, të qarkut të Beratit.

5. Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar.

6. Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit, në qendrat rezidenciale.

7. Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit, në qendrat ditore.

8. Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat më aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore.

9. Për ristrukturimin e Institutit të Studimeve dhe Projekttimeve të Industrisë së Lehtë.

10. Për lirimin dhe caktimin e administratorëve të shoqërive huamarrëse, në administrim.

2. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 13.12.2006

VENDIME për propozim projektligjesh

1. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit të Komuniteteve Europiane, "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006, për Shqipërinë"

2. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të

Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 1998".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 13.12.2006

1. "Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit të Komuniteteve Europiane, "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006, për Shqipërinë"

2. "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 1998".

3. Për dhënie ndihmë financiare familjeve të ish oficerëve të Gardës së republikës, Vangjel Kiço Çondi, Qemal Bilal Koni, Demush Hajdar Hebah, dhe të ish mjekut të QSU-së, "Nënë Tereza", Tiranë, Sandër Preng Baloj, për rast vdekjeje gjatë kryerjes së detyrës.

4. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët kufitare-Muriqan-Sukobin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi, në Muriqan.

5. Për miratimin e protokollit "Për disa ndryshime në marrëveshjen "Për bashkëpunimin financiar, 1996, në projektin "Planifikimi familjar III", të nënshkruar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, në datë 16.12.2004".

6. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes strategjike, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor Europian.

7. Për një ndryshim në vendimin nr.551, datë 2.8.2006, të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e numrit të punonjësve buxhetorë, për vitin 2006, në ministritë dhe institucionet qendrore", të ndryshuar.

8. Për pagesën e anëtarëve, në përbërjen e komisioneve për vlerësimin, miratimin dhe certifikimin e teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera ndihmëse, në sistemin arsimor parauniversitar të aktivizuar për vitin 2006.

9. Për një shpërblim të veçantë të punonjësve të Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe Provimeve.

10. Për shlyerjen e disa detyrimeve të ndërjella të ndërrmarrjeve publike.

(vijon në faqen 7)

NGA MBLLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN NËNTOR 2006

(Vijon nga faqja 6)

11. Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (Pjesa e Parë) + (Pjesa e Dytë) të pronave të paluajtëshme shtetërore, në bashkinë Tiranë, të qarkut të Tiranës.
12. Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot – Rrëshen, pjesë e koridorit Durrës – Morinë.
13. Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë - Kapshticë.
14. Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës portuale në protin e Durrësit.
15. Për një ndryshim në vendimin nr.231, datë 11.5.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin në Shërbimin Civil dhe periudhën e provës”, të ndryshuar.
16. Për transferimin në pronësi të truallit dhe të objekteve të disa agjensive të rezervave të shtetit, nga Ministria e Brendëshme njësive respektive të qeverisjes vendore.
17. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror
z. XHEMAL MEÇI
18. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror
z. MIHO GJINI
19. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror
z. HAMIDE XHAJA
20. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror
z. HYSEN KOÇIJA
21. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror
z. PANO TAÇI
22. Për dhënie fondi ndihme Partisë Shqiptare “At-dheu”

3. MBLLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 20.12.2006

VENDIME për propozim projektligjesh

1. Për propozimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për pjesëmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit, Durrës, Shqipëri”
2. Për propozimin e projektligjit “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare”.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 20.12.2006

1. Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për pjesëmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit, Durrës, Shqipëri.
2. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së tregtisë së lirë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe republikës së turqisë.
3. Për lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” me Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC), për shërbime konsulence, për realizimin e procesit të ristrukturimit dhe privatizimit të operatorit të sistemit të shpërndarjes (OSHS) të energjisë.
4. Për krijimin e Shoqërisë “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a.
5. Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.
6. Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Aviacionit Civil të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për financimin e pjesshëm, me objekt prokurimi “Studimi i Zhvillit të trafikut në aeroportin e Kukësit dhe të zonës Vlorë – Sarandë”.
7. Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Rumanisë, për bashkëpunim ekonomik, shkencor dhe teknik.
8. Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
9. Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë, të qëndrueshëm.
10. Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare.
11. Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartën përkatëse, për qytetin e Tiranës dhe rrethin e Kavajës.
12. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror
z. PERIKLI ÇULI
13. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror
z. TAJAR KOKALARI

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR POLICINË E SH-TETIT”

1. Komente të përgjithshme

1. Konteksti

a. Ligji ekzistues për Policinë e Shtetit u miratua në nëntor të vitit 1999 dhe tashmë konsiderohet nga Komuniteti Ndërkombëtar si faktor pengues në modernizimin dhe reformimin e shërbimit policor. Prandaj, ky projektligj ka për qëllim të heqë praktikën e mëparshme, si dhe të sqarojë dhe të vërë në zbatim një praktikë më të mirë që nxit procesin e reformave. Kjo është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për përmbushjen e kërkesave për procesin e Pranimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

b. Në maj të vitit 2005, një grup ekspertësh ndërkombëtarë u takuan për të shqyrtuar ndryshimet që duheshin bërë në ligjin ekzistues, me qëllim që ai të ishte në përputhje me standardet perëndimore. Ky grup përbëhej nga përfaqësues të OSBE-së, ICITAP-it dhe Misionit PAMECA. Pas një sërë mbledhjesh, grupi arriti në përfundimin se përpjekjet për të riparuar ligjin ekzistues nuk do të ishin dobiprurëse dhe se i duhej rekomanduar Ministrit të Rendit Publik të asaj kohe hartimi i një Ligji të ri. Në rekomandim thuhej gjithashtu se Grupi i Punës që do të hartonte ligjin e ri, përveç organizmave ndërkombëtare të përfaqësuar, duhej të përbëhej edhe nga përfaqësues të Ministrisë së Mëparshme të Rendit Publik, Ministrisë së Drejtësisë dhe Policisë së Shtetit.

c. Projektligji për Policinë e Shtetit përfshin pjesërisht ose tërësisht ligjet ekzistuese: Ligji i ndryshuar nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, Ligji nr. 8293, datë 26.02.1998 “Për Policinë Kriminale”, Ligji nr. 8342, datë 06.05.1998 “Për Policinë Kufitare”, Ligji i ndryshuar nr. 8292, datë 25.02.1998, “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”, Ligji i ndryshuar nr. 7498, datë 05.07.1991, “Për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë”, Ligji nr. 8643, datë 20.07.2000 “Për gradat”.

d. Projektligji synon t'i krijojë mundësinë Policisë së Shtetit të përmbushë kërkesat e marrëveshjes së Pranimit në BE duke e depolitizuar Policinë, duke decentralizuar buxhetin për të mundësuar menaxhimin e përbashkët të organizatës, zbatimin e strukturave moderne të menaxhimit, prezantimin e konceptit të policimit në komunitet dhe përdorimin e praktikave të duhura lidhur me menaxhimin dhe politikën e personelit. Secila prej këtyre temave u diskutua në Takimin e 13-të Konsultativ të Task Forcës, mbajtur në 10 shkurt 2006. Shteti shqiptar, nëpërmjet përfagësuesve të tij në këtë takim, ra dakort për të zbatuar mekanizmat e nevojshme për të bërë të mundur ndryshimin në këto fusha.

2. Karakteristikat kryesore të procesit legjislativ

Grupi i Punës filloi zyrtarisht punën e tij në Gusht 2005 dhe përbëhej nga përfaqësues të: Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë së Shtetit OSBE-së, ICITAP-it PAMECA-s. Përveç kësaj, u kontraktuan tre këshilltarë ndërkombëtarë në etapa të ndryshme të procesit të hartimit të ligjit, për të këshilluar grupin e punës.

Emri/Shteti

Kualifikimi

Dr. Robert WADMAN, Profesor i së Drejtës në Universitetin SH.B.A Weber, SHBA dhe ish punonjës policie

Z. Frank-Martin HEISE, Jurist, Policia e Hamburgut Gjermania

Dr. Jennifer TOOZE, Juriste në Ministrinë e Brendshme Britania e Madhe për hartimin e legjislacionit

Gjatë punës, anëtarë nga grupe të tjera pune, të cilët punojnë në fusha të përafërta, u bënë pjesë e grupit për të dhënë këshilla për fushat që lidheshin me punën e tyre. Këto përfshinin çështje lidhur me Ligjin për Gradat dhe riorganizimin e Akademisë së Policisë. U bënë konsultime edhe me Avokatin e Popullit lidhur me krijimin e Sindikatës së Policisë si dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me detyrat e policisë gjatë zgjedhjeve. Gjatë procesit të hartimit të ligjit në të gjitha rastet, komentet e bëra u morën parasysh

3. Përmbajtja kryesore

Projektligji përmban 7 Pjesë dhe 132 nene. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e shkurtër e Pjesëve, ndërsa përmbajtja dhe rëndësia e secilit nen jepet më tej në këtë Memorandum.

Pjesa I

Përkrahje e shkurtër e përmbajtjes

1. Dispozita të përgjithshme, ku përfshihet marrëdhënia ndërmjet Ministrit dhe Policisë.

2. Organizimi i Policisë, ku përfshihet struktura, hierarkia, gradat, ngritja në gradë, emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm, lidhjet me organizatat ndërkombëtare dhe organizmat e tjerë, si dhe njësitë operacionale speciale.

3. Menaxhimi i Policisë, ku përfshihet emërimi, kualifikimet, detyrat kryesore, procedurat disiplinore dhe çështjet e punësimit.

4. Kompetencat e Policisë, ku përfshihen: detyra për të ruajtur rendin publik, masat speciale dhe përdorimi i forcës.

3. Detyrat në lidhje me zgjedhjet.

(Vijon në faqen 9)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 8)

b. Dispozita të ndryshme lidhur me sigurinë në komunitet, përpunimin e të dhënave si dhe medaljet dhe certifikatat. 7. Dispozita kalimtare dhe të fundit që përfshijnë një sistem të detajuar për kalimin në sistemin e ri të gradave, shfuqizimi i akteve dhe hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Vlerësimi i efekteve

Projektligji:

a. Ka gjasa që të ketë ndikim financiar nëpërmjet akteve nënligjore që do hartohen në zbatim të tij. Një shembull është neni 11, i cili parashikon se struktura e Policisë përcaktohet në aktin normativ të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në strukturë dhe, për pasojë, në të gjithë institucionin e Policisë së Shtetit do të kenë efekte financiare. Për çdo akt normativ do të përgatitet një relacion, në të cilin do të përcaktohen efektet financiare. Për këtë arsye, ky dokument nuk përmban detaje të tilla.

b. Neni 84 përcakton një sërë detyrimesh me efekte financiare që ka Policia ndaj Sindikatës së Policisë. Këto detyrime janë të vogla dhe mbulojnë nga buxheti aktual.

c. Neni 98 përcakton rastet për të cilat mund të nevojitet kompensim për qytetarët që lëndohen gjatë dhënies së ndihmës për Policinë. Nuk është e mundur të përcaktohet kostoja e këtyre kompensimeve të mundshme.

d. Neni 102. Marrja e kampioneve të ADN-së ka efekte financiare. Në kuadër të ndihmës që po i jepet Laboratorit të Policisë Shkencore nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar do të përcaktohet se kur do të mundësohet krijimi i bankës së të dhënave të ADN-së.

e. Të gjitha efektet e mësipërme financiare janë të pashmangshme nëse Policia e Shtetit dëshiron të arrijë standartet e Pranimi në BE për një shërbim efektiv dhe efikas.

2. Komente të veçanta

1) Ekzistojnë një numër ligjesh që lidhen me sektorë të veçantë të Policisë ose me detyra të veçanta që kryhen nga Policia. Projektligji synon t'i bashkojë këto në një dokument të vetëm. Ky bashkim nënkupton që të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit kanë përgjegjësi të njëjtë për kryerjen e të gjitha funksioneve të Policisë së Shtetit, pavarësisht nga sektori apo departamenti ku shërbejnë. Ky bashkim është shumë i rëndësishëm si në lidhje me imazhin në publik, ashtu edhe me efektivitetin dhe efikasitetin e punës në të ardhmen.

2) Ligji ekzistues i Policisë së Shtetit nuk e përcakton qartë konceptin e depolitizimit të Policisë. Kjo është një kërkesë themelore në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme për Pranim në Bashkimin Evropian. Projektligji përcakton qartë se Policia si institucion dhe përfaqësuesit e këtij institu-

cioni janë të depolitizuar, por kjo nuk ka të bëjë me individët në jetën e tyre private.

3) Ligji ekzistues i Policisë së Shtetit nuk përcakton përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Si rezultat ka mbivendosje të kompetencave dhe kontroll politik të personelit, buxhetit dhe operacioneve të Policisë. Projektligji e përcakton qartë ndryshimin në përgjegjësitë në lidhje me këto fusha.

4) Projektligji përcakton në mënyrë specifike të drejtën e punonjësve të Policisë për të formuar Sindikatën e tyre, por ndalon të drejtën për grevë. E drejta për të formuar Sindikatën është kërkesë sipas ligjeve të Komunitetit Evropian.

5) Projektligji krijon mundësitë për të ngritur sistemin e të Dhënave për Krimin. Drejtësia nuk mund të administrohet siç duhet, nëse autoriteti që jep dënimin nuk është në dijeni të aktivitetit të mëparshëm kriminal të personit.

6) Projektligji fillon procesin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen për anëtarësim në Europol nga institucionet shqiptare përsa i përket Përpunimit të të Dhënave.

3. Komente mbi Projektligjin

1. Përgatitja e Projektligjit

a. Gjatë gjithë procesit të hartimit të projektligjit është respektuar hierarkia e ligjeve në Shqipëri.

b. Grupi i punës kishte në përbërjen e tij përfaqësues nga organizmat kryesore të interesuara; për pasojë, konsultimi gjatë fazës së hartimit u kufizua në nene të veçanta për të cilat, organizmat që nuk kishin përfaqësues, kishin interes të veçantë. Me përfundimin e draftit, një kopje e tij iu dërgua Misionit EURALIUS për komente. Ata mbështesin parimet që përmban ky projektligj.

2. Komentet mbi përmbajtjen kryesore të projektligjit

Tabela më poshtë jep shpjegimet e nevojshme mbi ligjin sipas neneve.

PJESA I

Dispozita të Përgjithshme

Neni Titulli/Përmbajtja

1 Objekti

Ky nen përcakton që Policia e Shtetit Shqiptar është shërbimi policor i Republikës. Është e rëndësishme të vihet në dukje përdorimi i termit 'shërbim' dhe jo 'forcë'. Kjo synon të trasmetojë idenë se Policia është një organizatë që u ofron shtetasve shqiptarë shërbimin e saj, dhe jo një forcë e Shtetit.

2 Qëllimi

Përcakton qëllimin e ligjit i cili është që Policia e Shtetit Shqiptar të plotësojë standartet e kërkuara për pranim në Bashkimin Evropian.

3 Juridiksioni i Policisë

(vijon në faqen 10)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 9)

Ky është një parim bazë që përcakton se Policia e Shtetit ka juridiksion në të gjithë territorin e Shqipërisë.

4 Përgjegjësitë e Policisë

Neni 4, paragrafi 1 përcakton përgjegjësitë e veçanta të Policisë, përgjithësisht të ngjashme me ato të nenit 3 të Ligjit të vitit 1999. Neni 4, paragrafet 2, 3 dhe 4 përcaktojnë detyrimin që çdo punonjës i Policisë të kryejë të gjitha detyrat e përcaktuara në paragrafin 1, pavarësisht strukturës në të cilën është emëruar dhe që të gjithë punonjësit e Policisë kanë atributet e Policisë gjyqësore. Është e rëndësishme të theksohet që përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë, JO vetëm oficerët, çka tregon se nuk ka dallim bazuar në gradë dhe mundëson një përdorim me fleksibël të burimeve në përputhje me praktikën më të mira të menaxhimit.

5 Simbolet e Policisë

Ky nen është i ngjashëm me nenin 5 të ligjit të vitit 1999. Është shtuar paragrafi 3 që ka për qëllim që në të ardhmen shenjat e përbashkëta ta dallojnë Policinë e Shtetit nga organizmat e tjera.

6 Statusi i Policisë

Neni 6, paragrafi 1 dhe 2 është përsëritje e neneve në ligjin e 1999-s. Paragrafi 3 parashikon në mënyrë specifike se Policia është e pavarur nga çdo parti apo organizatë politike. Kjo është një nga kërkesat për pranim në BE.

7 Marrëdhëniet ndërmjet Policisë dhe Ministrisë

Ky nen depolitizon në mënyrë të veçantë Policinë, duke ndarë qartë rolet e Ministrisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm. Ky nen është një nga më të rëndësishmit e projektligjit në kuadër të dokumentit të Pranimit (MSA). Ai ndan qartë menaxhimin operacional të Policisë nga sigurimi i buxhetit, caktimi i objektivave dhe menaxhimi i kryerjes së detyrave.

8 Buxheti i Policisë

Asnjë organizatë nuk mund të vetë-menaxhohet me efektivitet pa pasur kontrollin e buxhetit të saj. Aktualisht Policia e Shtetit nuk e ka këtë kontroll. Kjo do të jetë gjithashtu në përputhje me projektin CARDS të BE-së, të quajtur RMIS (Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Burimeve) për Policinë e Shtetit.

9 Fonde të veçanta

Ky nen parashikon që Ministri i bën propozime Këshillit të Ministrave për pagimin e informatorëve, etj. një fushë kjo veçanërisht e ndjeshme.

10 Përkufizimet

Neni përkufizon një sërë termash të përdorura në projektligj. Synon të sqarojë lexuesin në lidhje me keto terma.

PJESA II

Organizimi i Policisë

11 Organizimi dhe struktura e Përgjithshme e Policisë

Struktura e Policisë duhet të reflektojë kushtet social-ekonomike të vendit dhe, për rrjedhojë, i nënshtrohet ndryshimeve më shpesh sesa është e pranueshme për një ligj. Në këtë mënyrë ky nen lejon Ministrin të krijojë një strukturë apo t'i propozojë Këshillit të Ministrave ndryshime pa pasur nevojë për ndryshime në ligj.

12 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Neni përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme në lidhje me funksionet mbështetëse të organizatës si dhe funksioneve të veçanta operacionale.

13 Drejtoria e Policisë së Qarqeve

Neni përcakton çfarë është Drejtoria e Policisë së Qarkut, përgjegjësitë e saj të drejtpërdrejta si dhe në mbështetje të Komisariateve dhe Stacioneve të Policisë brenda zonës së saj.

14 Komisarariatet

Neni përcakton çfarë është një Komisarjat, rolin dhe përgjegjësitë e tij.

15 Stacionet e Policisë

Neni përkufizon Stacionin e Policisë.

16 Verifikimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Neni përcakton përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme në rastet e moskryerjes si duhet të detyrave nga Drejtoria e Qarkut, si dhe masat që merren nëse dyshimet për moskryerjen vërtetohen.

17 Verifikimi

Si neni më sipër, për përgjegjësitë e një strukture më të lartë në lidhje me strukturat më të ulëta.

18 Departamenti i Kufirit dhe Migracionit

Departamenti i Kufirit dhe Migracionit trajtohet në tërë ligjin si një subjekt brenda Policisë së Shtetit. Në këtë mënyrë përmbushen kërkesat e marrëveshjes Schengane për Pranim në BE. Neni pasqyron nenin 12 në lidhje me Drejtorinë e Përgjithshme. Ky nen dhe të tjerë në lidhje me Policinë e Kufirit dhe Migracionit i plotësojnë tërësisht shqetësimet e shprehura nga Delegacioni Evropian për zhvillimin e një Departamenti gjysëm-autonom brenda Policisë së Shtetit.

19 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë

Ky nen përcakton se kush e emëron Drejtorin e Përgjithshëm dhe parashikon përgjegjësitë e pozicionit në lidhje me kontrollin operacional dhe buxhetin.

20 Kriteret për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë

Neni siguron vazhdimësi në vendim-marrje në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm për çdo lloj ar-

(Vijon në faqen 11)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 10)

syje. Kjo ka për qëllim të përfshijë edhe vendimarrjen e përditshme në nivelet më të larta drejtuese. Ndërsa organizata bëhet më e sofistikuar në marrjen e vendimeve aktet normative ose rregulloret që do të hartohen për zbatim të këtij ligji do të përcaktojnë nivelet e funksioneve për marrjen e vendimeve.

27 Drejtorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë

Neni përcakton strukturën drejtuese të Drejtorive të Drejtorisë së Përgjithshme dhe është në përputhje me praktikën më të mira të menaxhimit.

28 Menaxhimi i përbashkët

Është parim i menaxhimit modern që, megjithëse përgjegjësia përfundimtare i takon një individ, në Policisë e Shtetit ky është Drejtori i Përgjithshëm, procesi i vendimarrjes duhet, për të shqyrtuar të gjitha fushat në tërësi, të jetë një punë në grup që përfshin gjithë drejtuesit më të lartë. Ky nen përcakton se nga kush përbëhet Grupi i Përbashkët i Politikave dhe cilat janë përgjegjësitë e tij. Të gjitha ndryshimet në politikën e përbashkëta që kanë ndikime në personel apo buxhet jashtë asaj që i takon normalisht një Departamenti apo Drejtorie duhet të paraqiten tek Grupi i Politikave. Kjo siguron komunikimin brenda organizatës si dhe kontrollin e duhur të buxhetit.

29 Drejtori i Policisë së Qarkut

Neni përcakton rolin dhe përgjegjësitë e një Drejtori të Policisë së Qarkut. Përcakton linjën e raportimit për Drejtorin e Qarkut.

30 Shefi i Komisarariatit

Ky nen përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Shefit të Komisarariatit. Përcakton linjën e raportimit për Shefin e Komisarariatit.

31 Shefi i Stacionit të Policisë

Ky nen përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Shefit të Stacionit të Policisë. Përcakton linjën e raportimit për Shefin e Stacionit.

32 Sistemi i gradave

Ky nen pasqyron përmbajtjen e nenit 22 të ligjit të vitit 1999.

33 Kuptimi për klasat dhe gradat

Ky nen jep kuptimin e klasave dhe gradave në Policinë e Shtetit.

34 Klasat

Gradat në Polici grupohen në katër grupe të quajtura klasa. Ky nen përcakton paraprakisht detyrat që do të kryhen nga çdo klasë dhe përfaqëson një nga kriteret sipas të cilave grada i korresponson funksionit.

35 Gradat

Ky nen përcakton çdo gradë në Policinë e Shtetit dhe klasën ku ajo bën pjesë. Paragrafi 2 i nenit konfirmon që punonjësit e emëruar në pozicionin e Drej-

torit dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm mbajnë funksione, jo grada dhe siguron bazën ligjore për rikthimin në gradën Drejtuesi i Parë.

36 Hierarkia e klasave dhe gradave

Neni vendos rregullat sipas të cilave përcaktohet hierarkia.

37 Paraqitja e gradave

Ndryshimet në paraqitjen e gradave kanë efekte të konsiderueshme financiare që bien mbi Policinë e Shtetit, ndaj këto ndryshime mund të bëhen vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

38 Përcaktimi i funksioneve për gradë

Grada e përshtatshme për çdo pozicion në Policisë e Shtetit përcaktohet si nga niveli i përgjegjësive që ka pozicioni ashtu edhe nga rëndësia e punës së kryer nga ai pozicion për organizatën. Numri i pozicioneve për gradë i korrespondon buxhetit të pagave për organizatën, ndaj është një vendim financiar që merret nga Këshilli i Ministrave, ku kostoja e punonjësve është zëri i vetëm më i madh në buxhetin vjetor dhe pika e fillimit për përgatitjen e buxhetit.

Ky nen eliminon praktikën sipas së cilës emërohen dhe paguhen punonjësit e lartë të Policisë për të kryer funksione që janë caktuar për t'u kryer nga punonjës të Policisë me gradë të ulët dhe për të pasur punonjës policie që të kryejnë të njëjtin funksion, por që mbajnë grada të ndryshme. Ruajtja e një strukture të caktuar gradash/funksionesh e zgjidh konfliktin midis menaxhimit dhe hierarkisë së urdhërave.

Një element kyç i një organizate moderne policore është që të gjithë punonjësit me të njëjtën gradë mund të shkëmbejnë pozicione mes tyre dhe të jenë të aftë të kryejnë çdo funksion që mbulohet nga grada e tyre. Një gjë e tillë krijon mundësi më të mëdha ecjeje në karrierë dhe ngritjeje në gradë.

39 Kalimi në klasën pasardhëse

Neni përcakton momentin kur punonjësi i Policisë kalon nga një klasë në tjetrën.

40 Ngritja në gradë

Neni përcakton kriteret e veçanta që duhet të plotësohen para se punonjësi i Policisë të ngrihet në gradë. Ka një rëndësi të jashtëzakonshme që këto kriteret të mirëpërcaktohen dhe të zbatohen, nëse Shqipëria kërkon të arrijë një shërbim policor profesional dhe të depolitizuar. Policimi në shekullin e 21-të kërkon aftësi profesionale dhe drejtuese. Mospërmbushja e standarteve profesionale për ngritjen në gradë të drejtuesve, çon në mënyrë të pashmangshme në mospërmbushjen e detyrave.

Neni prezanton një sistem transparent e konkurses i cili është një aspekt shumë i rëndësishëm për zh-

(Vijon në faqen 12)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 11)

villimin e një etike drejtimi bashkëkohore në Polici. Ngritjet në gradë nëpërmjet konkurimit garantojnë që vetëm punonjësit më të kualifikuar dhe të përgatitur të ngrihen në një gradë më të lartë. Dhënia e mundësisë të diplomuarve për të konkuruar për gradën që në fillim të karrierës jo vetëm i inkurajon të diplomuarit që të kërkojnë të bëjnë karrierë në Polici, por edhe e inkurajon punonjësën e ri të ndjekë studimet e larta.

41 Fitimi i gradës

Paragrafi 1 i këtij neni përcakton tre mënyrat e ngritjes në gradë. Ngritja nga grada Nëninspektor në Inspektor bëhet automatikisht pas kryerjes me sukses të periudhës dyvjeçare të provës, ndaj mund të bëhet nga Drejtori i Policisë së Qarkut. Si pjesë e depolitizimit të Policisë dhe në përputhje me praktikën më të mira të menaxhimit, ngritjet në gradat Kryeinspektor dhe të gjitha gradat duke përfshirë edhe gradën Drejtues i Parë, kryhen nga Drejtori i Përgjithshëm në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 44. Ngritjet në funksionet Drejtor i Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm janë emërime politike, sikurse përcaktohet në nenin 19 dhe 22.

Asnjë person nuk mund të marrë gradë si punonjës policie, sikurse përcaktohet në nenin 10, paragrafi 1/a në Policinë e Shtetit, nëse ky person nuk përmbush të gjitha kriteret e këtij neni. Një personi që futet në Policinë e Shtetit si punonjës në Shërbimet Mbështetëse, sikurse përcaktohet në nenin 10, paragrafi 1/b, mund të marrë gradën për pozicionin për të cilin është caktuar, por ky person nuk mund të kalojë nga punësimi sipas nenit 10, paragrafi 1/b në punësimin sipas nenit 10, paragrafi 1/a pa përmbushur kërkesat e këtij neni.

Sipas nenit 38, numri i punonjësve në çdo gradë përcaktohet dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ngritjet në gradë mund të bëhen vetëm për të plotësuar vendet bosh sipas këtij numri. I vetmi përjashtim nga ky rregull janë punonjësit e marrë mbi këtë numër, nëse ata janë të caktuar në një funksion i cili ka një kohëzgjatje të kufizuar dhe konsiderohet i rëndësishëm për funksionimin e Policisë së Shtetit. Kjo shtesë nuk duhet të kalojë 2% të numrit total në këto pozicione.

Ky nen plotëson nenin 40 duke kërkuar që punonjësit e Policisë të ngrihen në gradë sipas rendit të gradave sipas listës, pas provimit për ngritjen në gradë dhe trajnimit për t'i pajisur ata me njohuritë për gradën e re.

42 Heqja dorë nga grada

Ky nen përcakton procedurat që zbatohen në këtë proces.

43 Ulja në gradë

Neni krijon një lloj fleksibiliteti në menaxhimin e procesit për të bërë ndryshime në strukturën organizative, që ka ardhur si pasojë ose e rrethanave që lidhen me buxhetin ose për nevoja të tjera në drejtim. Neni respekton të Drejtat e Njeriut në këtë proces.

44 Ruajtja e gradës

Ky nen përcakton procedurat që zbatohen në këtë proces sipas kushteve të përcaktuara më sipër në nenin 41.

45 Marrëdhëniet me të tretët

Ky nen rregullon marrëdhëniet mes Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera publike.

46 *Organizatat Ndërkombëtare dhe organizmat jashtë shtetit të barasvlershme me Policinë.* Ky nen e lejon Policinë e Shtetit të shkëmbejë informacion, t'u japë këshilla dhe ndihmë organizmave jashtë vendit. Gjithashtu, ai u jep punonjësve të Policisë së Shtetit të drejtën të bëhen anëtarë si dhe të komandohen me detyrë në misionet ndërkombëtare policore.

47 Pagesa për shërbimet e Policisë

Ofrimi i shërbimeve policore në ambiente private psh. koncerte që zhvillohen në mjediset private për të fituar para, janë jashtë diapazonit të detyrave të zakonshme të Policisë. Nëse kërkohen shërbime të tilla, atëherë duhet të bëhet pagesa përkundrejt një shkalle të paracaktuar, me qëllim që buxheti i shtetit të mos konsiderohet si një mekanizëm që mbështet fitimet private.

PJESA III

Menaxhimi i Policisë

48 E drejta për t'u pranuar në polici

Ky nen përcakton kërkesat që një person mund të konkurojë për t'u futur në Polici. Reflekton trajnimin e ri bazë policor në procesin e tij fillestar.

49 Trajnimi

Ky nen kërkon nga Policia e Shtetit që të punësojë të gjithë personat e zgjedhur për të ndjekur kursin bazë dhe që e përfundojnë atë me sukses. Ndaj, bie mbi organizatën detyra që të planifikojë vendet bosh që parashikohen, si dhe të marrë në punë vetëm për të plotësuar këto vende bosh.

50 Kualifikimet e personave të trajnuar jashtë shtetit

Ky nen i lejon personat e trajnuar jashtë shtetit, në varësi të caktimit të standarteve të trajnimit, të pranohen në Policinë e Shtetit, pasi të kenë përfunduar një kurs përkatës trajnimi mbi legjislacionin shqiptar.

51 Emërimi në Polici

Neni përcakton procedurat e emërimit.

52 Caktimi i detyrave dhe transferimi i punonjësve

(Vijon në faqen 13)

PROJEKTLIGJE NË PROCES *Projektligji "Për Policinë e Shtetit"*

(Vijon nga faqja 12)

Neni përcakton përgjegjësinë për caktimin e detyrave.

53 Transferimet

Neni përcakton nivelet e autoritetit për kryerjen e transferimeve. Qëllimi i dhënies së autoritetit për transferime të punonjësve të Policisë në Drejtorinë e Qarqeve, Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit është që t'u krijojë atyre mundësinë që të zhvillojnë aftësitë e punonjësve të nivelit operacional dhe të nivelit të parë drejtues.

54 Ndarja e detyrave në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit

Detyrat e punonjësve të Policisë në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit lidhen me specialitetin dhe kërkojnë trajnim si në njohjen e ligjit edhe në përdorimin e pajisjeve. Me qëllim që organizata të arrijë të nxjerrë shpenzimet e bëra, është e rëndësishme që punonjësit e trajnuar të lihen në këtë specialitet të paktën për tri vjet. Ky afat kohor nuk zbatohet nëse do t'i shkaktonte individit disavantazhe ekonomike. Një shembull do të ishte shtyrja e ngritjes në gradë.

55 Vlerësimi i punonjësve të Policisë

Në një organizatë të madhe vlera më e rëndësishme dhe e kushtueshme janë punonjësit. Prandaj është e rëndësishme që në mënyrë të rregullt të vlerësohen aftësitë dhe dobësitë e të gjithë punonjësve, të parët të shpërblehen dhe të dobët të trajnohen sipas nevojave apo të emërohen në vende të tjera. Vlerësimi nuk duhet përdorur për çështje disipline.

56 Lirimi dhe largimi nga Policia

Ky nen përcakton kriteret për sa më sipër.

57 Ripranimi në Polici

Ky nen përcakton kriteret për ripranim sipas nenit 56 (2).

58 Dhënia e pajisjeve

Ky nen përcakton dy parime të rëndësishme, e para që të gjitha pajisjet që mbahen nga punonjësit e Policisë duhet të miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe e dyta, që pajisje të tilla, përfshirë edhe automjetet, të përdoren vetëm për detyra policore. Përdorimi i pajisjeve të Policisë për qëllime jashtë detyrës duhet konsideruar shkelje disiplinore.

59 Detyrimi për të zbatuar urdhëra të bazuara në ligj

Neni e shtron si kërkesë në ligj zbatimin e një urdhëri të ligjshëm. Kjo parashikohej edhe në ligjin e vitit 1999.

60 Detyrimi për të kryer detyrat pa diskriminim

Neni është në përputhje me kërkesën e Konventës Evropiane mbi Të Drejtat e Njeriut dhe Nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo mund të konsiderohet përsëritje e panevojshme, por respektimi i të Drejtave të Njeriut është kaq i rëndësishëm për përparimin e Policisë së Shtetit, sa nevojitet parashikimi i tij në ligjin e Policisë.

61 Detyrimi për të respektuar dinjitetin dhe integritetin fizik

Ky nen zgjeron në mënyrë specifike detyrimin e parashikuar në nenin 60 ndaj punonjësve të tjerë të Policisë.

62 Detyrimi për të parandaluar arratisjen nga një ndalim i ligjshëm

Shpjegohet në nen.

63 Detyrimi për garantimin e ndihmës mjekësore Shpjegohet në nen.

64 Detyrimi për të dhënë ndihmë gjatë ushtrimit të detyrës

Ky nen e ngarkon një punonjës të Policisë me detyrimin për të mbrojtur një punonjës tjetër të Policisë, kur ai gjykon se kjo ndihmë nevojitet. Ky nen është i përgjithshëm dhe nuk ka përcaktime specifike në lidhje me Departamente, funksione apo specialitete. Pra, është detyrë e punonjësve të departamenteve të ndryshme të ndihmojnë njëri tjetrin. Një shembull do të ishte kur një punonjës i Policisë së Rendit Publik ka për detyrë të mbrojë një punonjës të Policisë rrugore në vendngjarjen e një aksidenti.

65 Detyrimi për të ruajtur pronën

Neni ngarkon me përgjegjësi një punonjës policie që të kujdeset për pronën e Policisë.

66 Detyrimi për të mos dhënë informacione të klasifikuara

Shpjegohet në nen.

67 Kufizimet në jetën politike të punonjësve të Policisë

Ndërsa punonjësit e Policisë kanë të drejtën demokratike për të mbështetur një parti politike dhe të votojnë në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, është e rëndësishme që ata të shihen si njerëz që janë të paanshëm në çështje të tilla. Prandaj, ky nen e ndalon punonjësin e Policisë të kryejë veprime të tilla, të cilat do të krijonin përshtypjen e militantizmit. “

68 Detyrimi për të respektuar uniformën

Shpjegohet në nen.

69 Detyrimi për të raportuar ankesat

Shpjegohet në nen.

70 Detyrimi për të raportuar një shkelje

Shpjegohet në nen.

71 Detyrimi për të raportuar shkeljet e disiplinës

Shpjegohet në nen.

72 Kufizimet për veprimtari të dyta

Ndërkohë që një punonjës policie mund të ketë një punë të dytë, kjo nuk duhet të ndërhyjë në kryerjen e detyrës së tij si punonjës policie, si për shkak të llojit të punësimit apo të kushteve të punësimit. Nëse një punonjës policie ka një punë të tillë, ai duhet të njoftojë lidhur me të. Në rast se anëtarët e afërm të familjes së tij kanë një biznes që kërkon çfarëdolloj forme mbikëqyrjeje ose një licensë për të cilën Policisë i kërkohet vërtetim, përsëri ai duhet të njoftojë lidhur me të.

Në të gjithë këtë nen qëllimi nuk është që të vihen kufizime në jetën private të punonjësve të Policisë, por që të

(Vijon në faqen 14)

PROJEKTLIGJE NË PROCES Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 13)

sigurohet që Policia e Shtetit është punëmarrësi kryesor për punonjësin e Policisë dhe se veprimtaritë jashtë punës së Policisë nuk dëmtojnë reputacionin e shërbimit.

73 Shkelja disiplinore

Ky nen përcakton se çfarë quhet shkelje disiplinore.

74 Masat disiplinore

Ky nen përcakton masat e mundshme disiplinore sipas një shkallëzimi në ngritje.

75 Procesi disiplinor

Ky nen, së bashku me nenet 76 dhe 77 përcakton procesin që duhet ndjekur në çështjet disiplinore për të mbrojtur të drejtat e punonjësve të akuzuar.

76 E drejta për ankim

Sikurse është përcaktuar në nenin 75.

77 E drejta për ankim në rastet e lirimit nga detyra

Përcakton të drejtën për ankim të punonjësve të Policisë kur u shkurtohet vendi i punës.

78 Afatet e evidentimit të masës disiplinore

Sikurse është përcaktuar në nenin 75.

79 Rregullorja e disiplinës

Në të gjithë ligjin ka nene që delegojnë hartimin e akteve nenligjore ose rregullores në zbatim të tij. Këto akte hartohen për fushat të cilat i nënshtrohen ndryshimeve më shpesh se ligji.

80 Hetimi i pavarur i sjelljes së punonjësve të Policisë

Sikurse neni 79 i këtij ligji, ky është një nen delegues që mundëson nxjerrjen e rregullores përkatëse për procesin e ankimit nga qytetarët për veprimet e Policisë. Kjo është një e drejtë themelore e qytetarëve në një shoqëri demokratike.

81 Sindikata e Policisë së Shtetit

Shteti shqiptar është i angazhuar që të lejojë krijimin e Sindikatave

82 Ndalimi i së drejtës së grevës

Policia e Shtetit shihet si një shërbim i domosdoshëm për

83 Ndalimi i përdorimit të mjeteve të Policisë në aktivitete sindikaliste

Shpjegohet në nen.

84 Detyrimet të Policisë ndaj Sindikatës së Policisë

Për të mbështetur Sindikatën për t'u organizuar në fillimet e saj ky nen përfshin detyrime ligjore, të cilat rregullohen me anë të marrëveshjes së ndërsjelltë sipas Ligjit mbi Sindikatat. Kjo përputhet me praktikën e ndjekur në vende të tjera të Evropës.

85 I përgjithshëm

Ky nen ndjek parimet e përcaktuara në nenin 79, me shtesën se Rregullorja e Personelit, e cila mund të ketë kosto financiare, kërkon miratimin e Këshillit të Ministrave.

86 Koha e punës dhe e pushimit

Shpjegohet në nen.

87 Rregullimi i pagave

Shpjegohet në nen.

88 Dhënia e pensionit dhe përfitimeve suplementare

Ky nen përfshin në këtë ligj nene nga ligje të tjera për t'i formalizuar ato.

89 Përparësia për rikthim në shërbim

Për kushte të caktuara ky nen është hartuar për të kufizuar barrën financiare të pagave kalimtare për buxhetin e shtetit.

90 Saza e të dhënave të shenjave të gishtave dhe AND-së së punonjësve të Policisë

Shpjegohet në nen.

PJESA IV

Kompetencat e Policisë

91 Detyrat

Ky nen përcakton dispozitat e përgjithshme për të ruajtur rendin dhe sigurinë publike.

92 Proporcionaliteti

Është parim themelor i të Drejtave të Njeriut se veprimet e organizmave shtetërore duhet të mos tejkalojnë situatën me të cilën përballen. Ky nen përcakton atë çka njihet si Parimi i Proporcionalitetit.

93 Ndërprerja e masave

Shpjegohet në nen.

94 Ekzekutimi i menjëhershëm

Ky nen përcakton masat mbrojtëse lidhur me veprimet e Policisë.

95 Masat për ruajtjen e rendit Shpjegohet në nen.

96 Përgjegjësia për gjendjen e objekteve

Ky nen përcakton përgjegjësinë e Policisë për të hequr apo mënjanuar rrezikun e mundshëm për qytetarët. Jepet një shembull për fëmijët në vendet e Evropës ku, fëmijë që kanë luajtur me frigoriferë të flakur, kanë ngelur brenda dhe janë asfiksuar. Ndaj nene të tilla i caktojnë Policisë detyrimin që të largojë burime të tilla rreziku.

97 Masat ndaj palëve të treta

Shpjegohet në nen.

98 E drejta e individit për të ndihmuar Policinë

Është detyrë e të gjithë qytetarëve për t'i ardhur në ndihmë Policisë nëse kërkohet një gjë e tillë. Ky nen përcakton nivelet e kompensimit, në qoftë se një person lëndohet gjatë dhënies së kësaj ndihme.

99 Njoftimi për paragitje në Polici Shpjegohet në nen.

100 Shoqërimi në Polici

Shpjegohet në nen.

101 Kontrolli i identitetit

Shpjegohet në nen.

102 Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit.

Ky nen ka qëllim të trefishtë.

(Vijon në faqen 15)

PROJEKTLIGJE NË PROCES **Projektligji “Për Policinë e Shtetit”**

(Vijon nga faqja 14)

1. Së pari, të përputhet me legjislacionin Evropian të të Drejtave të Njeriut për t'u siguruar se mbahen si duhet të dhënat e personave që arrestohen, ndalohen apo shoqërohen për të garantuar që qëllimi ishte i ligjshëm dhe se personi është trajtuar në përputhje me ligjin.

2. Së dyti, për të krijuar Bazën e të Dhënave Kriminale për çdo person. Marrja e vendimit nga Gjykata nuk mund të kryhet si duhet nëse Gjykata nuk disponon të dhënat e mëparshme të personit. Zakonisht kjo bëhet me anë të gjurmëve të gishtërinjve.

3. Metodatat e hetimit modern mbi krimin gjithnjë e më shumë bazohen në metoda shkencore në formë fotografish, gjurmë gishtërinjsh dhe ADN-së. Ky nen krijon bazën ligjore për marrjen e tyre.

103 Largimi nga vendndodhja

Ky nen është një masë parandaluese dhe duhet të përdoret vetëm kur nuk mund të ndiqet rruga e zakonshme ligjore. Ai duhet të përdoret në rastet kur punonjësi i Policisë, për shkaqe të arsyeshme, ka frikë se dhuna do të fillojë ose do të vazhdojë nëse një nga palët nuk largohet. Nje shembull që lidhet me këtë do të ishte dhuna në familje. Në të gjitha rastet, kur ndërmerret një veprim sipas këtij neni, çështja duhet t'i dërgohet një autoriteti ligjor kompetent në rastin më të parë.

104 Bllokimi i rrugëve

Shpjegohet në nen.

105 Masat mbrojtëse

Shpjegohet në nen.

106 Trajtimi i të shoqëruarve

Ky nen garanton të drejtat e një personi të shoqëruar, të përcaktuara në legjislacionin Evropian për të drejtat e njeriut.

107 Bllokimi i sendeve

Shpjegohet në nen.

108 Kontrolli i personit

Kontrolli i personit është një çanim i mundshëm i të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, kushtet kur bëhet një kontroll i tillë dhe mënyra e kontrollit përcaktohen me hollësi në këtë nen.

109 Kontrolli mjekësor i personit

Si për nenin 108.

110 Kontrolli i objekteve

Ky nen parashikon me ligj atë çka tashmë është konsideruar si praktikë e mirë duke mundësuar kështu mbrojtjen e qytetarëve.

111 Hyrja dhe kontrolli i mjediseve

Si për nenin 110.

112 Kontrolli antiterrorist

Shpjegohet në nen.

113 Mbledhja e informacionit dhe të dhënave

Ky nen krijon bazën ligjore për mbledhjen e informacionit me qëllim parandalimin dhe zbulimin e

krimit. Në këtë mënyrë ai vendos kufizime për të mundësuar mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

114 Bashkëpunimi i fshehtë me individët

Shpjegohet në nen.

115 Masa të veçanta

Ky nen krijon bazën ligjore për grumbullimin e informacionit kriminal në formë elektronike, por gjithashtu përcakton gradën e punonjësit i cili mund të autorizojë bërjen e kërkesës te Prokurori për mbledhjen e informacionit kriminal. Në këtë mënyrë sigurohet që çanimi i të drejtave të njeriut ka bazë ligjore.

116 Veprimtaria informative

Shpjegohet në nen.

117 Përdorimi i forcës

Ky nen prezanton konceptin e “Vazhdimësisë së Forcës” brenda parimit të proporcionalitetit. Kjo do të thotë që një punonjës policie duhet të marrë parasysh përshkallëzimin e forcës së përdorur në kushte të veçanta, duke mbajtur parasysh gjithmonë faktin se forca nuk duhet të ushtrohet më shumë nga ç'kërkohe për zgjidhjen e konfliktit.

118 Përdorimi i armëve të zjarrit

Shpjegohet në nen.

119 Masat e detyrueshme mjekësore

Shpjegohet në nen.

120 Kryerja e operacioneve speciale

Shpjegohet në nen.

PJESA V

Zgjedhjet

121 Përfshirja e punonjësve të Policisë gjatë zgjedhjeve

Ky nen plotëson Kodin Zgjedhor dhe ka për qëllim që të lejojë Policinë e Shtetit të kryejë funksionet e saj të përcaktuara me hollësi në atë kod.

122 Mbajtja e armës nga Policia gjatë zgjedhjeve

Si për nenin 121.

123 Karta identifikuese

Si për nenin 121.

PJESA VI

Të ndryshme

124 Policimi në Komunitet

Ky nen përcakton bazën ligjore për ndryshimin kulturor që po kalon Policia e Shtetit. Kalimi nga një forcë shtypëse e Shtetit në një organizatë shërbimi për qytetarët. Njëkohësisht njeh faktin se Siguria në Komunitet nuk është prerogativë vetëm e Policisë, por është përgjegjësi e të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizmave lokalë. Neni përcakton detyrimin ligjor që ka Policia për t'u konsultuar me komunitetin, për të identifikuar shqetësimet e tij dhe për të hartuar plane për zgjidhjen e tyre.

125 Përpunimi i të dhënave personale

(Vijon në faqen 16)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 15)

Ky nen përputhet me parimet evropiane të mbrojtjes së të dhënave dhe detyrimet e Policisë së Shtetit sipas marrëveshjes për hyrjen në Europol.

126 Medaljet e Nderit dhe certifikatat

Shpjegohet në nen.

127 Llojet e medaljeve dhe certifikatave

Shpjegohet në nen.

PJESA VII

Dispozita kalimtare dhe të fundit

128 Kalimi në sistemin e ri të gradave

Ky nen jep një shpjegim të detajuar të procedurës së kalimit në sistemin e ri të gradave.

129 Trajtimi i personelit

Shpjegohet në nen.

130 Shfuqizimi i akteve

Shpjegohet në nen.

131 Miratimi i akteve normative

Shpjegohet në nen.

132 Hyrja në fuqi

Shpjegohet në nen.

4. Shtojcë 1

Marrëveshje ndërkombëtare dhe akte të Bashkimit Evropian në zbatim të të cilave nxirret ky projektligj:

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 4 nëntor 1950.

- Parime Bazë për përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit nga punonjësit që kanë kompetenca në zbatim të ligjit. - Adoptuar nga Kongresi i tetë i OKB-së mbi parandalimin e krimit dhe trajtimin e shkelësve të ligjit, Kubë, 27 gusht deri në 7 shtator 1900.

- Marrëveshja Schengen, 26 mars 1995.

- Konventa për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, 28 janarit 1981

- Konventa e Europol-it, 26 korrik 1995

- Udhëzime të BE-së për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në Ballkanin Perëndimor, 2003

5. Shtojcë 2

Efektet financiare që rrjedhin nga përcaktimet e Projektligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Pas studimit të Projektligjit dhe përlllogaritjeve të bëra efekteve financiare që rrjedhin nga vënia në zbatim e këtij projekti, rezulton:

Nga përcaktimet e bëra në Projektligj, sipas nenit 18-të, “Departamenti i Kufirit dhe Migracionit”,

1. Në projektligj Departamenti i Kufirit dhe Migracionit është i organizuar si strukture në vartësi vertikale nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit. Në këtë organizim nevojiten që të rikonstruktohen apo ndertohen disa ambjente pune në godinat e Drejtorive të Policisë në Qarqe per Drejtoritë e Kufirit dhe Këto ambjente përveç ndërimit kërkohen të kompletohen me pajisjet e duhura (përveç

atyre që kanë aktualisht) për akomodimin e punonjësve dhe krijimin e kushteve për punë, por efektet financiare të tyre janë përlllogaritur në kuadër të miratimit të projektbuxhetit 2007 dhe Programin Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2007 -2009, të cilat nuk mund të merren parasysh në efektet që vijnë nga miratimi i Ligjit “Për Policinë e Shtetit, pasi janë shifra pak a shumë të njëjta me faktin e viteve të kaluara.

2. Neni 32-37 “Sistemi i gradave ne polici.....” dhe modelimi i uniformave.

Në projekt parashikohet një ndryshim rrënjësor i sistemit të gradave në policinë e shtetit, për këtë nevojitet kompletimi i menjëhershëm me grada të reja pas një konkursi për miratimin e formës dhe të prodhimit të tyre. Në funksion të këtyre ndryshimeve kërkohet edhe modelimi dhe prodhimi i stemave dhe vetem modelimi i uniformës. Për të gjitha nevojiten:

· Kostoja e modelimit dhe e prodhimit të gradave të reja arrin në 150 mijë Euro

· Kostoja e modelimit dhe e prodhimit të stemave të reja arrin në 100 mijë Euro

· Kostoja e modelimit të uniformës arrin në 100 mijë Euro

· Shuma për “Gradat dhe uniformën...” 350 mijë Euro

Theksojmë se pas miratimit të Ligjit të ri të Policisë së Shtetit do të miratohet Vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e modelimit të gradave dhe simboleve sipas funksioneve.

Pas miratimit të VKM-së dhe inkuadrimit të gradave të policisë, mund të përcaktojmë efektet financiare më të sakta që sjell zbatimi i ligjit. Sjellim në vëmendje këtë argument pasi dhe nëse mund të krijojmë një ide për gradat sipas funksionit, nuk mund të jenë të sakta për punonjësit e policisë që do të përfitojnë këto grada pasi mund të ketë probleme me vjetërsinë e shërbimit etj. Ndërsa efektet e modelimit dhe të prodhimit nuk kanë efekte për miratimin e Ligjit për Policinë e Shtetit” pasi janë në kuadër të ndryshimeve të domosdoshme të modelit të gradave, stemës e simboleve, për të cilën është ngritur një Grup Pune Ndërministror pranë Këshillit të Ministrave për këtë problem.

Përfundimisht efektet financiare të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”, janë vetëm rreth 350 mijë Euro.

KËSHILLI I MINISTRAVE

(Vijon në faqen 17)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 16)

PROJEKTLIGJ PËR POLICINË E SHQIPËRISË

Neni 1

Objekti

1. Policia e Shtetit Shqiptar, në vijim Policia, është shërbimi policor i Republikës së Shqipërisë.
2. Misioni i Policisë është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i normave dhe procedurave për pranimin, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e marrëdhënieve të punës në Polici, si edhe për garantimin e të drejtave, përcaktimin e detyrave dhe të përgjegjësive të punonjësve të Policisë, për garantimin e një shërbimi policor demokratik, profesional dhe të frytshëm.

Neni 3

Juridiksioni i Policisë

Policia ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Përgjegjësitë e Policisë

1. Përgjegjësitë e Policisë janë, si më poshtë:
 - a) të mbrojnë jetën e njerëzve, sigurinë dhe pronën e tyre personale;
 - b) të parandalojnë, të zbulojnë dhe të hetojnë, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural penal, veprat penale dhe autorët e kryerjes së tyre;
 - c) të mbrojnë rendin dhe sigurinë publike;
 - ç) të mbikëqyrnë dhe të drejtojnë trafikun rrugor, në rrugë, për përdorim publik, në përputhje me legjislacionin rrugor;
 - d) të mbikëqyrnë dhe kontrollojnë kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë;
 - dh) të mbrojnë individë, mjedise dhe objekte të caktuara nga rreziqe të mundshme;
 - e) të administrojnë dhe të mbrojnë informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacion;
 - ë) të kryejnë detyrat e parashtruara në këtë ligj, në ligje të tjera, si dhe në aktet nënligjore, të cilat parashikojnë detyra për Policinë.
2. Çdo punonjës i Policisë ka për detyrë të përmbushë të gjitha përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, pavarësisht se cilës strukturë i shërben.
3. Çdo punonjës i Policisë ka atributet e policisë gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin përkatës, për organizimin dhe funksionimin e kësaj policie.

Neni 5

Simbolet e Policisë

1. Policia ka flamurin dhe stemën e vet, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Ngjyra, pajisjet e veçanta dhe shenjat në mjetet e Policisë përcaktohen me urdhër të ministrit të Brendshëm, në vijim ministri.

3. Forma, përmasat dhe të dhënat, që përmban dokumenti identifikues i punonjësit të Policisë, përcaktohet me urdhër të ministrit.

Neni 6

Statusi i Policisë

1. Policia është institucion i administratës publike në Republikën e Shqipërisë, në varësi të Ministrisë së Brendshme, në vijim Ministria.
2. Statusi i Policisë nuk ndryshon edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.
3. Policia është e depolitizuar.

Neni 7

Marrëdhëniet ndërmjet Policisë dhe ministrit

1. Ministri ka përgjegjësinë të sigurojë efektivitetin dhe eficientën e punës së Policisë. Në përgjegjësitë e ministrit nuk përfshihet drejtimi operacional i Policisë.
2. Përgjegjësitë e ministrit janë:
 - a) të përcaktojnë objektivat strategjike vjetore për Policinë;
 - b) të caktojnë objektivat e kryerjes së detyrave nga Policia;
 - c) të nxjerrin urdhëra dhe udhëzime, në përputhje me këtë ligj ose me ligje të tjera;
 - ç) të kërkojnë raporte, informacione dhe dokumente të tjera, që lidhen me kryerjen e detyrave nga Policia, në përgjithësi, ose në lidhje me ndonjë çështje të veçantë.
3. Në këtë dispozitë nuk parashikohet që Policia të japë:
 - a) informacione sekrete, që kanë të bëjnë me identitetin, procesin e bashkëpunimit, të mbrojtjes ose vendndodhjen e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose informatorëve;
 - b) informata konfidenciale, të përfuara nga personat e përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, informacione, për të cilat prokurori ka urdhëruar, me shkrim, që të këshillohen vetëm nga persona të caktuar.
4. Ministrit i raportohet çdo vit nga drejtori i Përgjithshëm rreth punës së Policisë.
5. Me kërkesën e tij, ministrit i raportohet nga drejtori i Përgjithshëm për çështje, të përgjithshme ose të veçanta, që lidhen me Policinë.

Neni 8

Buxheti i Policisë

1. Policia ka buxhetin e vet të veçantë, të miratuar nga Kuvendi. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë është përgjegjës për menaxhimin, efektiv dhe eficient, të buxhetit të miratuar.

(Vijon në faqen 18)

PROJEKTLIGJE NË PROCES **Projektligji “Për Policinë e Shtetit”**

(Vijon nga faqja 17)

2. Auditimi i buxhetit të Policisë kryhet nga organet e përcaktuara me ligj

Neni 9

Fonde të veçanta

1. Buxheti i Policisë ka një zë të veçantë për pagesën e personave për rastet e operacioneve të veçanta polico-re dhe për informatorët.

2. Këto fonde administrohen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Neni 10

Përkufizime

1. Personeli i Policisë

Ka dy kategori të personelit të Policisë.

a) Punonjësit e Policisë, që kanë kompetenca operacionale të plota, përfshirë kompetencat e ndalimit dhe të arrestimit. Ata mund të jenë punonjës policie, me ose pa uniformë.

b) Punonjësit në shërbimet mbështetëse, që janë emëruar në Polici pa u diplomuar në Akademinë e Policisë ose që nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim tjetër policor, të miratuar (neni 50).

2. Lirimi dhe largimi nga puna (neni 56)

a) Lirim nga Policia do të thotë një situatë, në të cilën marrëdhëniet, juridike dhe administrative, të punonjësit të Policisë me institucionin e Policisë së Shtetit ndërpriten për arsye të cilat nuk ia hegin përgjithmonë të drejtën për t'u rikthyer në Polici.

b) Largim nga Policia do të thotë një situatë në të cilën marrëdhëniet juridike dhe administrative të punonjësit të Policisë me institucionin e Policisë së Shtetit ndërpriten pa asnjë mundësi rikthimi në Polici.

3. Ekzekutimi i menjëhershëm (neni 94)

Një veprim i ndërmarrë nga një punonjës policie sapo kupton rrezikun, pa urdhrin e eprorit.

4. Masat për ruajtjen e rendit

Masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike përfshijnë tërësinë e veprimeve të ligjshme, të cilat duhet të kryhen nga punonjësi i Policisë, duke filluar nga forma verbale e bindjes deri te përdorimi i forcës vdekjeprurëse, për rivendosjen e rendit, në përputhje me legjislacionin.

5. Strukturat e kufirit dhe migracionit

Të gjitha nenet në ligj, që u referohen drejtimit dhe kontrollit, verifikimit, hartimit të raporteve, vjetore dhe të veçanta, ose kompetencave për të transferuar personelin, të zbatueshme për drejtuesit e drejtorve të qarkut, komisariateve dhe stacioneve të policisë do t'u referohen, gjithashtu, drejtuesve të drejtorve, komisariateve dhe stacioneve të policisë së kufirit dhe të migracionit.

6. Shoqërimi (neni 100)

Shoqërimi, në kuptim të këtij ligji, nënkupton çuarjen e një personi pranë zyrave të Policisë, me ose pa vull-

netin e tij, për qëllime administrative ose në zbatim të legjislacionit penal.

7. Akademia e Policisë

Akademia e Policisë është një term përgjithësues, i përdorur në këtë ligj, për të nënkuptuar të gjitha elementet e kualifikimit policor: Shkollën bazë të policisë, trajnimin e specializuar, trajnimin e drejtuesve, etj.

PJESA E DYTË

ORGANIZIMI I POLICISË

KREU I

STRUKTURA

Neni 11

Organizimi dhe struktura e përgjithshme e Policisë

1. Policia organizohet në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme përbën nivelin qendror të Policisë, ndërsa drejtoritë e policisë së qarkut, drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit dhe strukturat në varësi të tyre përbëjnë nivelin vendor të saj.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton numrin e përgjithshëm të punonjësve të Policisë.

3. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe e sektorëve të saj, ku përfshihen drejtoritë e policisë së qarqeve, drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit, komisarariatet, komisarariatet e kufirit dhe migracionit, stacionet e policisë dhe stacionet e kufirit dhe migracionit, si dhe limiti i organikës së këtyre strukturave miratohen nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

Neni 12

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe e ka vendndodhjen në kryeqytetin e vendit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë përbëhet nga një numër departamentesh.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë:

a) mbështet drejtorin e Përgjithshëm të Policisë në kryerjen e detyrave;

b) mbikëqyr kryerjen e funksioneve dhe të detyrave të policisë nga drejtoritë e policisë në qarqe.

c) bashkërendon çështjet, që lidhen me rekrutimin dhe trajnimin e punonjësve të Policisë;

ç) bashkërendon vënien në zbatim të strategjive, për parandalimin dhe reduktimin e krimit, ruajtjen e rendit publik, mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve shtetërorë dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse, ruajtjen e sigurisë kombëtare;

d) bashkërendon kryerjen e funksioneve dhe të detyrave të Policisë;

dh) bashkërendon vënien në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, për çështje që lidhen me Policinë.

(Vijon në faqen 19)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 18)

e) përpunon të dhënat e mbledhura nga Policia deri në masën që është e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të Policisë;

ë) kryen detyra policore, në përputhje me këtë ligj, me ligje të tjera dhe me aktet normative, të bazuara në këtë ligj ose në ligje të tjera.

4. Drejtorja e Përgjithshme e Policisë mund t'i propozojë grupit të përbashkët të politikave:

a) udhëzimet organizative, që lidhen me personelin, si dhe ato që janë thelbësore për operacionet e Policisë, përfshirë formimin e njësisve speciale për kryerjen, sipas rastit, të detyrave të veçanta;

b) strategjitë për parandalimin dhe reduktimin e krim-it, ruajtjen e rendit publik, mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve shtetërorë, dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse, ruajtjen e sigurisë kombëtare;

c) planet financiare, vjetore dhe afatgjata, për Policinë.

Neni 13 Drejtoritë e policisë së qarqeve

1. Për qëllime policimi, Republika e Shqipërisë ndahet në qarqe, të cilat duhet të përputhen, sa më shumë të jetë e mundur, me ndarjen e vendit në qarqe, përveç ndarjeve të përcaktuara në nenin 18, që kanë të bëjnë me rajonet, për qëllime policimi të kufirit dhe migracionit.

2. Ndarja në qarqe, për qëllime policimi, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

3. Për çdo qark, sipas pikës 2, ka një drejtor të policisë së qarkut. Numri i personave, që punojnë në drejtorinë e policisë së qarkut dhe specialitetet e tyre caktohen nga Drejtorja e Përgjithshme e Policisë, sipas nevojave të secilit qark, pas këshillimit me drejtorin e policisë së qarkut.

4. Drejtorja e policisë së qarkut mbështet dhe mbikëqyr çështjet operacionale policore, të ndërmarra nga komisariatet dhe stacionet e policisë, të cilat përfshihen në qarkun e policisë, që ajo drejton.

5. Drejtorja e policisë së qarkut:

a) ushtron funksionet dhe detyrat specifike, të përcaktuara në ligj dhe në udhëzimet e nxjerra nga Drejtorja e Përgjithshme e Policisë, sipas shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 12, të këtij ligji;

b) mbikëqyr kryerjen e funksioneve dhe të detyrave të Policisë nga çdo komisariat dhe stacion policie, në qarkun e policisë, që ajo mbulon;

c) bashkërendon çështjet e personelit dhe të trajnimit, që lidhen me komisariatet dhe stacionet e policisë, në qarkun e policisë, që ajo mbulon.

Neni 14

Komisariatet

1. Çdo drejtor të policisë së qarkut përbëhet nga komisariate.

2. Numri i komisariateve brenda drejtorisë së policisë së qarkut dhe numri e specialiteti i personave, që

punojnë në këto komisariate, reflekton kërkesat për policim në zonë dhe miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm:

3. Komisariati ndërmerr detyra operacionale, në përputhje me funksionet e Policisë.

Neni 15

Stacionet e policisë

Stacionet e policisë ngrihen dhe funksionojnë me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe me propozimin e drejtorit të qarkut në zona të caktuara gjeografike, brenda territorit të një komisariati.

Neni 16

Verifikimi nga Drejtorja e Përgjithshme e Policisë

1. Nëse Drejtorja e Përgjithshme e Policisë ka të dhëna se një drejtor të policisë së qarkut nuk po i kryen ose nuk i ka kryer detyrat si duhet ose në kohën e duhur, ajo verifikon moskryerjen e detyrës.

2. Nëse nga verifikimi, sipas pikës 1, dyshimet vërtetohen, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë njofton drejtorin e drejtorisë së policisë së qarkut për moskryerjen e detyrës dhe merr masat e mëposhtme:

a) urdhëron drejtorin e policisë së qarkut të ndregë, brenda një kohe të caktuar, pasojat e ardhura nga moskryerja e detyrës;

b) identifikon masat e mundshme për të ndrequr pasojat e moskryerjes, dhe i kërkon drejtorit të policisë së qarkut t'i zbatojë ato;

c) ndreq me nismën e vet pasojat dhe zbaton masa të veçanta, të cilat mund të jenë, gjithashtu, kompetencë e drejtorisë së policisë së qarkut.

Neni 17

Verifikimi

Verifikimet mund të kryhen nga çdo strukturë e lartë ndaj strukturave më të ulëta brenda juridiksionit të saj, lëndor dhe territorial.

Neni 18

Departamenti i kufirit dhe i migracionit

1. Departamenti i kufirit dhe i migracionit vendoset në kryeqytetin e vendit.

2. Departamenti i kufirit dhe i migracionit drejton dhe ushtron kontroll mbi të gjitha strukturat vartëse të kufirit dhe migracionit. Për qëllime të mbikëqyrjes dhe të kontrollit të kufijve, Republika e Shqipërisë ndahet në rajone; për çdo rajon ka një drejtor të rajonale të kufirit dhe migracionit. Numri i drejtorive rajonale, komisariateve dhe stacioneve të kufirit dhe migracionit përcaktohen nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm dhe zëvendës-drejtorit të Përgjithshëm të kufirit dhe migracionit.

3. Departamenti i policisë së kufirit dhe migracionit:

a) mbështet zëvendës-drejtorin e Përgjithshëm të kufirit dhe migracionit në kryerjen e detyrave;

b) mbikëqyr kryerjen e detyrave nga drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit në varësi të tij, si dhe

(Vijon në faqen 20)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 19)

nga çdo njësi vartëse, që raporton drejtpërdrejt tek ai;

c) në raste të veçanta, mbikëqyr kryerjen e detyrave nga ndonjë tjetër njësi yartëse e kufirit dhe migracionit.

4. Departamenti i kufirit dhe migracionit i propozon grupit të përbashkët të politikave:

a) strukturën organizative për personelin, si dhe udhëzime të tjera për operacionet e departamentit të kufirit dhe migracionit dhe të strukturave të tij vartëse.

b) strategjitë për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve shtetërorë;

c) planet financiare, vjetore dhe afatgjata, për departamentin e kufirit dhe të migracionit dhe të strukturave të tij vartëse.

5. Pas miratimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, departamenti i kufirit dhe migracionit bashkërendon punën për vënien në zbatim të politikave dhe strategjive, që, në mënyrë të veçantë, lidhen me:

a) rekrutimin e punonjësve të Policisë në departamentin e kufirit dhe të migracionit, të strukturave të tij vartëse dhe trajnimin e tyre.

b) mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve shtetërorë;

c) kryerjen e funksioneve dhe të detyrave të departamentit të kufirit e migracionit dhe të strukturave të tij vartëse;

ç) vënien në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështje që lidhen me departamentin e kufirit e të migracionit dhe strukturave të tij vartëse.

6. Departamenti i kufirit e migracionit dhe strukturat vartëse të tij mbledhin dhe përpunojnë të dhëna të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tyre.

KREU II

FUNKSIONET

Neni 19

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë emërohet nga Këshilli i Ministrave, bazuar në propozimet e paraqitura nga ministri.

2. Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë administrativ, teknik dhe operacional i Policisë.

3. Drejtori i Përgjithshëm:

a) drejton dhe kontrollon Policinë;

b) i rekomandon ministrit, në fillim të çdo viti financiar, buxhetin që do t'i jepet Policisë për vitin e ardhshëm financiar;

c) ndan buxhetin e miratuar nga Kuvendi ndërmjet departamenteve, drejtorive, sektorëve, komisariateve dhe stacioneve të policisë, sipas përparësive të vendosura nga ministri.

ç) menaxhon dhe është përgjegjës për buxhetin e miratuar për Policinë.

Neni 20

Kriteret për emërimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë emërohet personi, që përmbush këto kriteret:

a) të ketë shërbyer për një periudhë të paktën 3 vjet me gradën drejtues i parë ose më lart ose ekuivalentin e kësaj grade;

b) të jetë shkolluar në Akademinë e Policisë, në përputhje me nenin 49, ose të ketë mbaruar një shkollë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave si të barazvlefshme me nivelin e shkollimit, që përputhet me nenin 50;

c) të ketë kryer jo më pak se 12 vjet shërbim si punonjës policie, duke ushtruar kompetenca policore, brenda 15 viteve të fundit.

Neni 21

Qëndrimi në detyrë i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë emërohet për një periudhë kohe prej pesë vjetësh, me të drejtë riemërimi për një periudhë prej 3 vjetësh.

2. Në rast se drejtori i Përgjithshëm i Policisë nuk riemërohet ose plotëson 8 vjet qëndrimi në detyrë, ai rikthehet në gradën dhe funksionin që mbante para emërimit si drejtor i Përgjithshëm i Policisë, ose, në pamundësi, në një funksion të barasvlershëm me të, sikurse përcaktohet në nenin 20, të këtij ligji.

Neni 22

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë

1. Çdo departament i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë drejtohet nga një zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë, sikurse përcaktohet në nenin 12, të këtij ligji.

2. Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm emërohen nga ministri, pas procedurës së aplikimit dhe rekomandimit të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

3. Roli dhe funksionet e zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm të Policisë përcaktohen në rregulloren e nxjerrë nga drejtori i Përgjithshëm dhe të miratuar nga ministri.

4. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm:

a) ndihmon drejtorin e Përgjithshëm të Policisë në kryerjen e funksioneve, në departamentin, që ai drejton;

b) drejton dhe ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi punonjësit e Policisë, të emëruar në departament;

c) i propozon drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, përpara fillimit të çdo viti financiar, pjesën e buxhetit, të miratuar nga Kuvendi për Policinë, që do t'i jepet veçanërisht, departamentit të tij për atë vit financiar;

ç) menaxhon dhe përgjigjet për buxhetin e dhënë për departamentin e tij nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

(Vijon në faqen 21)

PROJEKTLIGJE NË PROCES Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 20)

Neni 23

Kriteret për emërimin e zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm

1. Sipas pikës 2, të nenit 22, të këtij ligji, zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë emërohet personi, që përmbush këto kriteret:

- a) të ketë shërbyer për një periudhë të paktën prej 3 vjetësh në gradën e drejtuesit të parë ose në një gradë të barasvlershme me të;
- b) të jetë shkolluar në Akademinë e Policisë, në përputhje me nenin 49, të këtij ligji, ose të ketë mbaruar një shkollë të miratuar nga Këshilli i Ministrave si të barasvlefshme me nivelin e shkollimit, që përputhet me nenin 50, të këtij ligji;
- c) të ketë kryer jo më pak se 11 vjet shërbimi në Polici, brenda 15 viteve të fundit.

2. Personi, i cili konkurren për postin e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të kufirit dhe migracionit duhet, sipas shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij neni, të ketë shërbyer në departamentin e kufirit dhe të migracionit për një periudhë kohe të paktën 2 vjet, me gradën e drejtuesit ose më lart ose me një gradë të barasvlefshme.

Neni 24 Qëndrimi në detyrë i zëvendës drejtorit të Përgjithshëm

1. Zëvendës drejtor i Përgjithshëm emërohet për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë riemërimi edhe për një periudhë trevjeçare.

2. Në rast se zëvendës drejtor i Përgjithshëm nuk riemërohet ose plotëson 7 vjet qëndrimi në detyrë, ai rikthehet në gradën dhe me të njëjtat kushte që ka patur para emërimit të tij si zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë, sikurse përcaktohet në nenin 23, të këtij ligji.

Neni 25

Largimi nga detyra i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe i zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm ose zëvendës drejtor i Përgjithshëm mund të largohet nga detyra për njërin nga arsyet e mëposhtme:

- a) Është dënuar për një vepër penale, me vendim gjyqësor, të formës së prerë.
- b) Është shpallur fajtor për shkelje të disiplinës, sipas rregullores së disiplinës, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji, që cakton si masë largimin nga detyra.
- c) Për mospërmbushje të objektivave strategjike dhe objektivave të kryerjes së detyrave të caktuara nga ministri, sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji.
- ç) Është i paaftë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj; d) Plotëson moshën për pension;
- dh) Jep dorëheqjen.

Neni 26

Autoriteti për të vepruar në emër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë

I. Ministri cakton njërin nga zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të ushtrisë kompetencat dhe detyrat e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë:

- a) në mungesë, në rast paafësie ose pezullimi nga detyra të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë;
- b) kur drejtori i Përgjithshëm i Policisë nuk është emëruar ende;
- c) në raste të tjera, me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

2. Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë, i caktuar sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 1, të këtij neni, nuk mund të ushtrijë kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm për një periudhë të pandërprerë mbi gjashtë muaj, përveçse me miratimin e ministrit.

Neni 27

Drejtorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë

Çdo drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë drejtohet nga një drejtor, i cili raporton te zëvendës drejtor i Përgjithshëm në krye të departamentit.

Neni 28

Menaxhimi i përbashkët

1. Menaxhimi i përbashkët realizohet nga grupi i përbashkët i politikave.

2. Grupi i përbashkët i politikave përbëhet nga drejtor i Përgjithshëm i Policisë, zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Policisë dhe drejtorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

3. Grupi i përbashkët i politikave drejtohet nga drejtor i Përgjithshëm i Policisë.

4. Grupi i përbashkët i politikave nuk është organ ekzekutiv. Ai është organi më i lartë këshillues i Policisë së Shtetit, për të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me:

- buxhetin;
- vendimet e organizatës, që përfshijnë më shumë se një departament;
- zhvillimin e politikave, të cilat ndikojnë në mënyrën se si Policia bashkëpunon me publikun;
- kryerjen e detyrave të drejtorive brenda strukturave të Policisë.

Ai është organ këshillimor për drejtorin e Përgjithshëm në ushtrimin e detyrave për zhvillimin e politikave dhe çdo vendimi, që ka lidhje me çështje të përbashkëta financiare, të personelit e të logjistikës.

5. Grupi i përbashkët i politikave shqyrton propozimet që i paraqiten nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, sipas nenit 12, të këtij ligji, dhe nga drejtoria qendrore e departamentit të kufirit dhe migracionit, sipas nenit 18.

(Vijon në faqen 22)

PROJEKTLIGJE NË PROCES **Projektligji “Për Policinë e Shtetit”**

(Vijon nga faqja 21)

6. Grupi i përbashkët i politikave mblidhet të paktën një herë në muaj. Struktura dhe procedurat e këtyre takimeve përcaktohen në rregulloret e nxjerra nga drejtori i Përgjithshëm.

Neni 29

Drejtori i policisë së qarkut

1. Çdo drejtori e policisë së qarkut drejtohet dhe kontrollohet nga drejtori i policisë së qarkut.

2. Drejtori i policisë së qarkut dhe drejtori rajonal i kufirit dhe migracionit raportojnë te drejtori i Përgjithshëm i Policisë, nëpërmjet zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, për:

a) kryerjen e detyrave;

b) kryerjen e detyrave nga drejtorja e policisë së qarkut, komisariatët dhe stacionet e policisë, që drejton dhe kontron.

3. Drejtori i policisë së qarkut i paraget drejtorit të Përgjithshëm të Policisë një raport vjetor, ose sa herë që drejtori i Përgjithshëm bën kërkesë, për punën e drejtorisë së policisë së qarkut, të cilën ai drejton dhe kontrollon, dhe punën e komisariateve dhe të stacioneve të policisë, në varësinë e tij.

4. Drejtori i policisë së qarkut raporton te drejtori i Përgjithshëm i Policisë, me kërkesë të tij, për çdo çështje, të përgjithshme ose të veçantë, të drejtorisë së policisë së qarkut, që drejton.

Neni 30

Shefi i komisarariatit

1. Komisarati drejtohet nga shefi i komisarariatit, i cili emërohet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

2. Shefi i komisarariatit raporton te drejtori i policisë së qarkut, në varësinë e të cilit është komisarati.

3. Shefi i komisarariatit duhet të paragesë një raport vjetor te drejtori i policisë përkatëse të qarkut mbi punën e komisarariatit, që ai drejton.

a) Punonjës policie i nivelit zbatues, që përfaqëson nivelin bazë të veprimtimit policor.

b) Punonjës policie i nivelit të parë drejtues, që përfaqëson drejtimin dhe veprimin operacional;

c) Punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues, që përfaqëson drejtimin ekzekutiv, qendror dhe/ose vendor;

ç) Punonjës policie i nivelit të lartë drejtues, që përfaqëson drejtimin strategjik.

Neni 35

Gradat

1. Emërtimet e gradave, sipas klasave dhe ecurisë në karrierë, janë:

a) Punonjës policie i nivelit zbatues:

- Nëninspektor;

- Inspektor;

- Kryeinspektor.

b) Punonjës policie i nivelit të parë drejtues:

- Nënkomisar;

- Komisar;

- Kryekomisar.

c) Punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues:

- Drejtues;

- Drejtues i parë.

ç) Punonjës policie i nivelit të lartë drejtues:

- Zëvendës drejtor i Përgjithshëm;

- Drejtor i Përgjithshëm.

2. Gradat sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij neni, janë funksionale. Këto grada merren nga punonjësi i Policisë në çastin e emërimit në detyrat e drejtorit ose të zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, sipas neneve 19, pika 1, e 22, pika 2, të këtij ligji, dhe lihen me largimin nga këto detyra.

Në këto raste punonjësi i Policisë rimerr gradën “Drejtues i parë” dhe vjetërsia në gradë, gjatë kohës që ka patur funksionet e përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, llogaritet si vjetërsi në këtë gradë.

Neni 36

Hierarkia e klasave dhe gradave

1. Hierarkia ndërmjet punonjësve të Policisë në klasa përcaktohet sipas kësaj renditjeje:

Drejtor i Përgjithshëm, drejtues, komisar, inspektor.

2. Brenda së njëjtës klasë, hierarkia e punonjësve të Policisë përcaktohet nga grada.

3. Hierarkia e punonjësve të Policisë me të njëjtën gradë përcaktohet nga funksioni, ndërsa për funksione të njëjta, hierarkia përcaktohet nga vjetërsia në gradë.

Neni 37

Paraqitja e gradave

Paraqitja, forma dhe ndërtimi i gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas zhvillimit të një procesi konkurrimi për dizenjimin e tyre.

Neni 38

Përcaktimi i funksioneve për gradë

Tabela e funksioneve korresponduese për çdo gradë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Kalimi në klasën pasardhëse

Punonjësi i Policisë kalon nga një klasë në tjetrën vetëm pas përfundimit të shkollimit përkatës, në çastin e marrjes së gradës më të ulët të klasës pasardhëse.

Neni 40

Ngritja në gradë

1. Ngritja në gradë nga “Inspektor” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet një procesi vlerësimi konkurrues, që përfshin raportet e vlerësimit të punës dhe një provimi, i cili teston aftësitë e aplikantëve për të marrë gradën pasardhëse. E drejta për të marrë pjesë në këtë proces përcaktohet në pikën 4, të këtij neni.

2. Grada “Nëninspektor” i jepet kursantit pas përfundimit me sukses të periudhës së shkollimit në shkollën bazë të Policisë. Kjo gradë, e cila i jep punonjësit kompetenca të plota policore mbahet nga punonjësi i Policisë gjatë periudhës së provës.

(Vijon në faqen 23)

PROJEKTLIGJE NË PROCES **Projektligji “Për Policinë e Shtetit”**

(Vijon nga faqja 22)

3. Ngritja në gradën “Inspektor” bëhet pas përfundimit me sukses të periudhës dyvjeçare të provës, e cila pason shkollën bazë të Policisë.

4. a) Punonjësit të Policisë i lind e drejta të aplikojë për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes, pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, sipas afatëve të mëposhtme:

(i) Nga “Inspektor” në “Kryeinspektor”

2 vjet;

(ii) Nga “Kryeinspektor” në “Nënkomisar”

2 vjet;

(iii) Nga “Nënkomisar” në “Komisar”

2 vjet;

(iv) Nga “Komisar” në “Kryekomisar”

2 vjet;

(v) Nga “Kryekomisar” në “Drejtues”

2 vjet;

(vi) Nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”

2 vjet; (vii) Nga “Drejtues i parë” në

“Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm”

3 vjet; (viii)

Nga “Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm” në “Drejtor të Përgjithshëm” pa afat kohor.

b) Punonjësit e Policisë, që kanë përfunduar një shkollë të lartë, të njohur nga shteti, dhe që kanë plotësuar, së paku, dy të tretat e minimumit të kohës, që kërkohet për qëndrimin në gradë, mund të konkurrojnë në procesin e përzgjedhjes për ngritjen në gradë nga “Inspektor” në “Kryeinspektor” dhe nga “Kryeinspektor” në “Nënkomisar”.

c) Në vjetërsinë, për efekt gradimi, llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të:

(i) paaftësisë së përkohshme shëndetësore, si pasojë e sëmundjes apo e dëmtimit për shkak të punës;

(ii) paaftësisë shëndetësore, e cila nuk ka ardhur si pasojë e punës, deri në 6 muaj, brenda afatit 12- muaj;

(iii) ushtrimin të funksioneve, sipas nenit 44, të këtij ligji;

(iv) pezullimit apo përjashtimit, për shkakë disiplinore, si rezultat i një urdhri ose vendimi të paligjshëm dhe/ose të padrejtë;

(v) pezullimit me pagesë, deri në përfundimin e hetimit të një kallëzimi ose një ankese, për sjellje në kundërshtim me rregulloren e disiplinës, deri sa autoriteti kompetent të marrë vendimin përfundimtar për çështjen.

ç) Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të:

(i) lejes së përfituar pa të drejtë pagese;

(ii) pezullimeve, për shkakë disiplinore. -

5. Procedurat për kryerjen e provimeve të ngritjes në gradë përcaktohen në rregulloren e personelit të Policisë dhe përfshijnë:

(i) Përbërjen e komisioneve të testimit. (ii) Procedurat e aplikimit.

(iii) Kriteret për të aplikuar.

(iv) Strukturën e provimeve, për ngritje në gradë.

(v) Përcaktimin dhe kohëzgjatjen e listës emërore, sipas radhës, të personave, që kanë të drejtë të ndjekin kursin për ngritje në gradë.

Neni 41

Fitimi i gradës

1. a) Ngritja në gradën “Inspektor” kryhet me urdhër të drejtorit të policisë së qarkut, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 40, të këtij ligji.

b) Ngritja në gradën “Kryeinspektor” dhe në të gjitha gradat e nivelit të parë dhe të atij të mesëm drejtues bëhen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 40, të këtij ligji.

c) Ngritja në gradën e nivelit të lartë drejtues bëhet në përputhje me nenet 19, pika 1, dhe 22, pika 3, të këtij ligji.

2.a) Ngritja në gradë bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë.

b) Punonjësit e Policisë mund të ngrihen në gradë vetëm pasi të kenë përfunduar, me sukses kursin e trajnimit përkatës për atë gradë.

c) Punonjësit e Policisë zgjidhen për të ndjekur kursin e trajnimit, bazuar në listën emërore të së drejtës për gradë, të hartuar pas procesit konkurrues.

ç) Pas përfundimit me sukses të trajnimit, përzgjedhja për ngritje në gradë bëhet sipas listës emërore të së drejtës për gradë, të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të këtij neni.

2. a) Numri i përlllogaritur për vendet e lira njoftohet brenda datës 31 mars të çdo viti.

b) Kuotat e pranimit në trajnim për secilën gradë përcaktohen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë, por nuk kalojnë:

(i) 5% mbi vendet e lira, të përlllogaritura për ngritjen në gradën e kryeinspektorit;

(ii) 10% mbi vendet e lira, të përlllogaritura për gradat e nivelit të parë drejtues;

(iii) 15% mbi vendet e lira, të përlllogaritura për gradat e nivelit të mesëm drejtues.

Neni 42

Heqja dorë nga grada

1. Punonjësi i Policisë ka të drejtë të kërkojë të heqë dorë nga grada që mban në një gradë më të ulët.

2. Heqja dorë nga grada, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të kërkohet vetëm për një gradë paraardhëse dhe jo më shumë se në dy raste gjatë karrierës policoe të punonjësit të Policisë.

3. Vendimi për kërkesën e punonjësit të Policisë për heqje dorë nga grada merret nga autoriteti përkatës, në përputhje me pikën 1, të nenit 41, të këtij ligji.

(Vijon në faqen 24)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 23)

4. Punonjësi i Policisë, i cili më parë ka hequr dorë, me kërkesën e vet, nga një gradë, ka të drejtë të kërkojë ngritje në gradë vetëm pas certifikimit nga komisioni i testimi dhe sipas procedurave, të përcaktuara në nenet 40 e 41, të këtij ligji.

Neni 43

Ulja në gradë

1. Me përjashtim të nivelit zbatues, kur, për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative të Policisë, shkurtohet numri i funksioneve organike për gradë, punonjësi i Policisë, që mban gradën ku do të kërkohej ulja, mund të kërkojë, në mënyrë vullnetare, uljen një gradë më poshtë, kur ka vende të lira.

2. Me krijimin e vendeve të lira për gradë, punonjësi i Policisë, që ka kërkuar ulje në gradë, rimerr menjëherë gradën e mëparshme, sipas të njëjtit kriter, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Neni 44

Ruajtja e gradës

Punonjësi i Policisë, që punësohet në struktura të tjera të administratës publike, në funksione, që kanë për objekt çështje të rendit e të sigurisë publike, si dhe kur ai shërben në një organizatë ndërkombëtare që mbulon çështje të rendit dhe të sigurisë publike, ruan gradën, që mbante në çastin e lirit.

KREU IV

MARRËDHËNIET ME PERSONA DHE ORGANIZMA TË TJERA

Neni 45

Marrëdhëniet me të tretët

1. Bashkëpunimi me institucionet e tjera qendrore të administratës publike rregullohet me akte normative, të përbashkëta.

2. Organet vendore të Policisë bashkëpunojnë me njësitë e geverisjes vendore në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe në zbatimin e ligjit, duke respektuar pavarësinë e tyre dhe karakterin unitar e të centralizuar të Policisë.

3. Organet e policisë së qarkut mbajnë marrëdhënie me prefektin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 46

Organizatat ndërkombëtare dhe organizmat jashtë shtetit, të barasvlefshme me Policinë

1. Policia mund t'i japë këshilla dhe ndihmesë një organizatë ndërkombëtare ose një institucioni shtetëror jashtë Republikës së Shqipërisë, që kryen funksionet e saj në nivel, kombëtar ose ndërkombëtar, sikurse përcaktohet në nenin 4, të këtij ligji. Këto kompetenca ushtrohen vetëm me miratimin e një punonjësi të Policisë, të gradës zëvendës drejtor i Përgjithshëm ose drejtor i Përgjithshëm.

2. Këshillimi dhe asistenca mund të jepen, sipas pikës 1, vetëm kur:

a) e kërkon organizmi apo institucioni;

b) dhënia e këshillës dhe asistencës autorizohet nga një marrëveshje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

3. Bazuar në pikat 1 e 2, me leje dhe autorizim të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të drejtorit ose zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Policia mund të dërgojë punonjës policie, për një periudhë të përkohshme shërbimi, në një organizatë ndërkombëtare apo bazuar në marrëveshje ndërkombëtare, të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, për përbushjen e detyrave policore a të detyrave të tjera joushtarake jashtë shtetit.

4. Marrëveshja përkatëse, e bërë sipas pikës 3, përcakton se në drejtimin dhe kontrollin e kujt do të jetë punonjësi i Policisë, kur ai është i angazhuar për një periudhë të përkohshme shërbimi, si dhe faktin nëse punonjësi i Policisë, gjatë kësaj kohe, nuk do të jetë nën drejtimin dhe kontrollin e ndonjë punonjësi të Policisë.

Neni 47

Pagesa për shërbimet e Policisë

Policia mund të ofrojë shërbime policore, me kërkesën e të interesuarve, në mjedise, goftë edhe private, në përdorim të publikut, me pagesë ose jo, përkundrejt një detyrimi financiar, të përcaktuar me vendimativ të Këshillit të Ministrave.

PJESA E TRETË

MENAXHIMI I POLICISË

KREU I

TË PËRGJITHSHME

Neni 48

E drejta për t'u pranuar në Polici

Ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar si punonjës policie çdo person, që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Është shtetas i Republikës së Shqipërisë;
- Ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
- Ka mbaruar shkollën e mesme;
- Jep informacionin e kërkuar për punën e tij të mëparshme ose ndonjë çështje tjetër, që lidhet me pranimin e tij në shërbimin policor;
- Nuk është dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Ka dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit, të tipit B.

Neni 49

Trajnimit

1. Kandidati, i cili përzgjidhet për t'u pranuar si punonjës i Policisë, duhet:

- të marrë trajnime profesionale në shkollën bazë të policisë, në përputhje me rregulloren e personelit, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji;

(Vijon në faqen 25)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 24)

b) të vihet në periudhë prove për dy vjet pas përfundimit të trajnimit bazë.

2. Kandidati, i cili është përzgjedhur si punonjës policie në një funksion e nuk kërkon ushtrimin e kompetencave policore, sipas legjislacionit penal dhe pjesës së katërt, të këtij ligji, duhet:

a) të marrë trajnimin përkatës në institucionin e shkollimit policor; b) të vihet në periudhë prove për një vit.

Neni 50

Kualifikimet e personave të trajnuar jashtë shtetit

1. Ekuivalentimi i trajnimeve të kryera jashtë shtetit me nivelin përkatës së Akademisë së Policisë bëhet me udhëzim të ministrit.

2. Një person, i cili është emëruar në Polici sipas këtij neni, duhet të kryejë trajnimin për njohjen e legjislacionit shqiptar, në Akademinë e Policisë dhe t'i nënshtrohet kriterëve të njëjta për ngritje në gradë, të përcaktuara në pikat 2 e 3, të nenit 40, të këtij ligji.

Neni 51

Emërimi në Polici

1. Një person emërohet në Polici me urdhër të ministrit, në çastin që pranohet në shkollën bazë të policisë.

2. Nëse personi është kualifikuar dhe diplomuar sipas nenit 49, ai caktohet në njësinë përkatëse të Policisë, me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm.

3. Ditën që pranohet në Polici, personi nënshkruan një kontratë, në përmbajtjen e së cilës ekzistojnë sanksione në rastet e refuzimit për të shkuar në vendin, ku është caktuar të shërbejë.

Neni 52

Caktimi i detyrave dhe transferimi i punonjësve

1. Personit të emëruar në Polici i caktohen detyra në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë, sipas nenit 12.

2. Personi i emëruar në Polici mund të caktohet me shërbim kudo goftë, brenda territorit të vendit.

3. Punonjësi i Policisë njoftohet të paktën një muaj përpara për vendimin për transferimin e tij jashtë rrethit, ku banon.

4. Pika 3 nuk zbatohet kur transferimi bëhet për nevoja të ngutshme shërbimi. Në këto raste transferimi nuk duhet të jetë për më shumë se dy muaj .

Neni 53

Transferimet

1. Drejtuesit e drejtorive të qarqeve, të drejtorive rajonale të kufirit dhe migracionit dhe drejtorive qendrore mund të transferojnë punonjës, me gradën inspektor, kryeinspektor dhe nënkomisar në pozicione, të cilat janë brenda drejtimit të tyre, me kusht që të dyja pozicionet të kërkojnë të njëjtën gradë.

2. Të gjitha transferimet e tjera kryhen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Neni 54

Ndarja e detyrave në departamentin e kufirit dhe të migracionit

1. Përveç rasteve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të këtij neni, një punonjësi të Policisë, të emëruar në departamentin e kufirit dhe të migracionit, duhet t'i nqarkohen detyra për një periudhë të pandërprerë të paktën 3- vjecare.

2. Përpara se një punonjës i Policisë të emërohet në departamentin e kufirit dhe të migracionit duhet të ketë përfunduar, me sukses, trajnimin e parashikuar për kufirn dhe migracionin.

3. Kur drejtori i Përgjithshëm i Policisë e vlerëson të nevojshme, për mbrojtjen e rendit e të sigurisë publike dhe të të drejtave të individëve, ai mund të vendosë që:

a) një punonjës i policisë të caktohet përkohësisht me detyra në departamentin e kufirit dhe të migracionit;

b) një punonjësi të policisë të emëruar në departamentin e kufirit dhe të migracionit, t'i caktohen detyra, të cilat nuk janë të njëjta me ato të departamentit të kufirit dhe të migracionit, për një periudhë jo më shumë se një muaj.

Neni 55

Vlerësimi i punonjësve të Policisë

Punonjësi i Policisë vlerësohet çdo vit dhe sa herë kërkohet ose është e nevojshme, në përputhje me rregulloren e personelit.

Neni 56

Lirimi dhe largimi nga Policia

1. Një punonjës i Policisë lirohet ose largohet nga Policia në përputhje me përcaktimet e këtij neni dhe kur është dhënë autorizimi i nevojshëm, sikurse përcaktohet në pikën 4, të këtij neni.

2. Një punonjës i Policisë lirohet nga Policia nëse:

a) deklarohet i paaftë nga ana shëndetësore, me vendim të komisionit mjeko-ligjor;

b) i shkërtohet funksioni organik dhe nuk kërkon ulje në gradë;

c) punësohet në struktura të tjera të administratës publike, në funksione, që kanë për objekt çështje të rendit e të sigurisë publike;

ç) mbush moshën për pension të plotë plegërie;

d) kërkon vetë të lirohet.

3. Një punonjës i Policisë largohet nga Polcia nëse dënohet me burgim, me vendim gjyqësor, të formës së prerë, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e largmt nga Policia.

4. Lirimi dhe largimi i punonjësit të Policisë bëhen me urdhër të titullarit, kompetent për emërimin e tij, sipas nenit 53, të këtij ligji.

Neni 57

(Vijon në faqen 26)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 25)

Ripranimi në Polici

1. Një person i liruar në përputhje me shkronjat "a", "b", "c" dhe "d", të pikës 2, të nenit 56, të këtij ligji, mund të ripranohet në Polici kur ka vende vakant në pozicionin, për të cilin ai ka kualifikimin e duhur. Nëse ripranimi bëhet brenda 12 muajve të pandërprerë, atëherë ai rifiton gradën e tij të mëparshme.

2. Nëse ripranimi bëhet pasi kanë kaluar 12 muaj të pandërprerë, punonjësi i Policisë vazhdon karrierën një gradë më poshtë nga ajo që mbante para lirimimit ose ricertifikohet për gradën, që mbante më parë.

Neni 58

Dhënia e pajisjeve

1. Punonjësi i Policisë ka të drejtë të mbajë armë. Llojet e armatimit, të lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe të mjeteve të tjera, të përdorimit të forcës nga Policia, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Punonjësit të Policisë i jepen në përdorim mjete dhe pajisje të tjera, sipas akteve normative të ministrit.

3. Pajisjet, ku përfshihen automjetet, që u jepen punonjësve të Policisë për kryerjen e detyrave të tyre, duhet të përdoren vetëm për qëllime pune.

KREU II

DETYRIMET KRYESORE TË PUNONJËSVE TË POLICISË

Neni 59

Detyrimi për të zbatuar urdhëra, të bazuara në ligj

1. Një punonjës i Policisë duhet të zbatojë të gjitha urdhërat që i jepen nga një person, më i lartë në funksion ose në gradë.

2. Kur një punonjës i Policisë ka shkage të mjaftueshme të dyshojë se urdhri i dhënë nga eprori i tij është i paligjshëm, ai duhet, pa vonesë, t'ia bëjë të ditur eprorit dhe të kërkojë, që urdhri të jepet me shkrim.

3. Punonjësi epror i Policisë ka detyrimin të japë urdhrin me shkrim, në rast se kërkohet, sipas pikës 2, të këtij neni.

4. Në rastet kur moszbatimi i urdhrin, deri në dhënien me shkrim të tij, sipas pikës 3, të këtij neni, rrezikon jetën e një personi tjetër, punonjësi i Policisë duhet të zbatojë urdhrin.

5. Kur një punonjës policie, edhe pas zbatimit të procedurave të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, vazhdon të ketë arsye për të dyshuar se urdhri është i paligjshëm, ai kryen veprimet e mëposhtme:

a) kundërshton urdhrin, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni;

b) vë menjëherë në dijeni titullarin, i cili është drejtpërdrejt mbi eprorin, që e ka dhënë urdhrin, si dhe për masat e marra prej tij, sipas këtij neni.

Neni 60

Detyrimi për të kryer detyrat pa diskriminim

Punonjësi i Policisë duhet t'i trajtojë personat në mënyrë të barabartë dhe duhet t'i kryejë detyrat pa diskriminim, në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare a filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, në përputhje me nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 61

Detyrimi për të respektuar dinjitetin dhe integritetin fizik

Punonjësi i Policisë, në çdo rast, duhet të respektojë dinjitetin dhe integritetin fizik të çdo punonjësi tjetër të Policisë, përfshirë edhe vartësit e tij.

Neni 62

Detyrimi për të parandaluar arratisjen nga një ndalim i ligjshëm

Punonjësi i Policisë ka për detyrë që, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar arratisjen e një personi në rastet e shoqërimit, të ndalimit apo arrestimit nga Policia.

Neni 63

Detyrimi për garantimin e ndihmës mjekësore

1. Kur një punonjës i Policisë i besohet ruajtja e një personi, për të cilin ai vlerëson se ka nevojë për kujdes mjekësor, punonjësi i Policisë duhet të kërkojë ndihmë mjekësore dhe të marrë masat e nevojshme, realisht të zbatueshme, për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e personit.

2. Nëse një punonjës policie dëmton një person gjatë kryerjes së një veprimi kur është në detyrë, ai duhet të kërkojë ndihmë mjekësore dhe të marrë masat e nevojshme dhe realisht të zbatueshme për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e personit.

Neni 64

Detyrimi për të dhënë ndihmë gjatë ushtrimit të detyrës

1. Punonjësi i Policisë duhet t'i vijë në ndihmë një punonjës tjetër të Policisë gjatë ushtrimit të detyrës kur vlerëson se ai ka nevojë për ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet.

2. Në rastet kur punonjësi i Policisë, që ofron ndihmën e tij është në shërbim, ai është i detyruar të vlerësojë dhe zbatojë përparësinë në kryerjen e detyrës.

Neni 65

Detyrimi për të ruajtur pronën

Punonjësi i Policisë është përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin, nga çdo dëmtim, të armatimit, pajisjeve dhe mjediseve, që i janë dhënë në përdorim për ushtrimin e detyrës dhe plotësimin e kushteve të punës dhe të jetesës.

(Vijon në faqen 27)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 26)

Neni 66

Detyrimi për të mos dhënë informacione të klasifikuara

1. Punonjësi i Policisë nuk duhet të japë informacione të klasifikuara, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme.

2. Pika 1, e këtij neni, përbën detyrim për zbatim edhe për punonjësit e Policisë, të liruar ose të larguar, nga Policia.

Neni 67

Kufizimet në jetën politike të punonjësve të Policisë

1. Punonjësi i Policisë nuk mund të jetë anëtar i një partie ose organizate politike.

2. Punonjësi i Policisë nuk mund të mbështesë fushatën e një partie ose organizate politike ose të një anëtarit të një partie politike apo të një kandidati të paruarur, duke marrë pjesë ose kontribuar, fizikisht ose financiarisht.

3. Punonjësi i Policisë ka për detyrë të ushtrojë funksionet e veta në mënyrë të paanshme dhe pavarësisht bindjeve të tij politike.

Neni 68

Detyrimi për të respektuar uniformën

Punonjësi i Policisë përdor uniformën, shenjat dhe simbolet e policisë vetëm gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 69

Detyrimi për të raportuar ankesat

Punonjësi i Policisë i raporton eprorit përkatës ose, në mungesë të tij, eprorit të eprorit, çdo ankesë të marrë për sjelljen e një punonjësi tjetër të policisë.

Neni 70

Detyrimi për të raportuar shkeljen

Punonjësi i Policisë i raporton eprorit përkatës, ose në mungesë të tij eprorit të eprorit, çdo shkelje, për të cilën ai ka dyshime të mjaftueshme të besojë se është kryer nga një person, pavarësisht nëse ai ka marrë dijeni për këtë shkelje gjatë kryerjes së detyrës ose në rrethana të tjera.

Neni 71

Detyrimi për të raportuar shkeljet e disiplinës

Punonjësi i Policisë i raporton eprorit përkatës ose në mungesë të tij eprorit të eprorit, çdo shkelje, për të cilën ai ka dyshime të mjaftueshme të besojë se është kryer nga një punonjës tjetër i Policisë, pavarësisht nëse ai ka marrë dijeni për këtë shkelje gjatë kryerjes së detyrës ose në rrethana të tjera.

Neni 72

Kufizimi për veprimtari të dyta

1. Punonjësi i Policisë nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari private, të cilat pengojnë plotësimin e kërkesave të detyrës.

2. Në rastet e dypunësimit, punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë, paraprakisht, strukturën përkatëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

3. Punonjësi i Policisë ka detyrimin të njoftojë paraprakisht strukturën përkatëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë nëse bashkeshorti/ja, prindërit, motrat e vëllezërit apo fëmijët e tij ndërmarrin një veprimtari apo drejtojnë një biznes, që mund të çojë në konflikt interesash me kompetencat dhe detyrën e tij si punonjës policie.

KREU III

PROCEDURAT E BRENDSHME DISIPLINORE

Neni 73

Shkelja disiplinore

Kur nuk përbën vepër penale vlerësohet shkelje disiplinore çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të Policisë, që bie në kundërshtim me rregulloren e disiplinës.

Neni 74

Masat disiplinore

1. Masat, që mund të merren ndaj punonjësit të Policisë në rastet e shkeljeve disiplinore, janë:

a) Vërejtje;

b) Vërejtje me paralajmërim;

c) Gjobë, në masën sa paga e punonjësit për pesë ditë pune;

ç) Shtyrja e afatit të gradimit nga një muaj deri në një vit;

d) Pezullimi pa pagesë, nga pesë ditë deri në tridhjetë ditë;

dh) Ulje jo më shumë se një gradë deri në 12 muaj;

e) Largimi nga Policia.

2. Masa disiplinore e dhënë duhet të jetë në përshatje me shkeljen e kryer dhe me pasojat e ardhura prej saj.

3. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të ketë përfunduar procesi disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të apelimit, dhe pasi të jetë dhënë vendimi përfundimtar.

Neni 75

Procesi disiplinor

1. Vendimi për masën disiplinore duhet t'i komunikohet, me shkrim, brenda 3 ditëve pune, vetë punonjësit të Policisë. Punonjësi i Policisë vihet, gjithashtu, në dijeni për të drejtën e tij për të apeluar vendimin.

2. Punonjësi i Policisë, i ndëshkuar me një masë disiplinore, ka të drejtë të marrë pjesë në procesin disiplinor dhe të ndihmohet nga një punonjës policie, i zgjedhur prej tij, me të njëjtën gradë ose me gradë më të lartë.

Neni 76

E drejta për ankim

1. Punonjësi i Policisë, ndaj të cilit merret një masë disiplinore sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 74, të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit të Policisë, që ka dhënë masën ndaj tij,

(Vijon në faqen 28)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 27)

brenda 5 ditëve nga çasti i marrjes dijani, për dhënien e masës disiplinore.

2. Punonjësi i Policisë, ndaj të cilit merret një masë disiplinore sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të nenit 74, të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet, me shkrim në komisionin e apelimit të punonjësve të Policisë, brenda 10 ditëve nga çasti i marrjes dijani me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

3. Procedurat disiplinore bëhen publike, me përjashtim të rasteve kur problemet që do të shqyrtohen klasifikohen sekrete.

4. Punonjësi i Policisë, ndaj të cilit merret një masë disiplinore sipas nenit 74, të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet edhe drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 77

E drejta për ankim në rastet e lirimit nga detyra

Çdo punonjës policie, i cili njoftohet se është dhënë autorizimi për t’u liruar nga detyra sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 56, të këtij ligji, ka të drejtë ta apelojë atë në komisionin e apelimit të punonjësve të Policisë ose drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 78

Afatet e evidentimit të masës disiplinore

1. Masat disiplinore, “Vërejtje”, “Vërejtje me paralajmërim” dhe “Gjobë në masën sa paga e punonjësit për pesë ditë pune” qëndrojnë në dosjen personale të punonjësit të policisë, për një periudhë prej 6 muajsh, periudhë pas së cilës shkatërrohen.

2. Masat disiplinore, “Shtyrja e afatit të gradimit nga një muaj deri në një vit”, “Pezullimi pa pagesë nga pesë ditë deri në tridhjetë ditë” dhe “Ulje deri në një gradë” qëndrojnë në dosjen personale të punonjësit të Policisë për një periudhë prej një viti nga data e përfundimit të ekzekutimit të masës, periudhë pas së cilës shkatërrohen.

3. Pas kalimit të periudhave, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, i gjithë dokumentacioni, që lidhet me masat disiplinore, të përcaktuara në shkronjat “dh” dhe “e”, të pikës 1, të nenit 74, vendoset në qendrën e të dhënave të personelit dhe ruhet gjatë të gjithë kohës së punës së këtij punonjësi. Këto të dhëna nuk mund t’i bëhen të ditura asnjë institucioni apo strukturë, pa lejen me shkrim të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

4. Masa disiplinore “Largim nga Policia” qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish – punonjësit të Policisë.

Neni 79

Rregullorja e disiplinës

Kategoritë dhe llojet e shkeljeve disiplinore, kriteret, rregullat, procedurat dhe dokumentacioni për dhënien e masave disiplinore, si dhe përbërja, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisionit të apelimit të punonjësve të Policisë përcaktohen

në rregulloren e disiplinës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 80

Hetimi i pavarur i sjelljes së punonjësve të Policisë

Procedurat për përcaktimin e veprimeve, që duhet të merren kur një qytetar beson se veprimet apo mosveprimet e punonjësit të Policisë kanë dhunuar të drejtat dhe liritë e tij, parashikohen në rregulloren e disiplinës, të miratuar nga ministri.

KREU IV

ÇËSHTJET QË LIDHEN ME PUNËSIMIN

Neni 81

Sindikata e Policisë së Shtetit

1. Sindikata e Policisë është një e vetme dhe ka për qëllim përfaqësimin e punonjësve të Policisë anëtarë të saj në të gjitha çështjet, që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës së tyre dhe efikasitetin në punë.

2. Sindikata e Policisë mund të përfaqësojë punonjësit e Policisë, anëtarë të Sindikatës, në mbrojtje të tij në të gjitha rastet e apelimit për çdo çështje të ngritur, në mbështetje të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

3. Të gjithë punonjësit e Policisë, me përjashtim të drejtorit të Përgjithshëm dhe zëvendësrektorëve të Përgjithshëm të Policisë, mund të jenë anëtarë të sindikatës.

4. Punonjësit e Policisë së Shtetit, që nuk dëshirojnë të jenë anëtarë të sindikatës së Policisë së Shtetit, duhet të dorëzojnë një kërkesë, me shkrim, në organin drejtues të Sindikatës.

5. Sindikata e Policisë krijohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 82

Ndalimi i së drejtës së grevës

Ky ligj u mohon punonjësve të Policisë së Shtetit të drejtën e grevës.

Neni 83

Ndalimi i përdorimit të mjeteve të Policisë në vepërimitarit, sindikaliste

Punonjësve të Policisë u ndalohet të mbajnë uniformën e Policisë, të mbajnë armë apo të përdorin ndonjë mjet policie gjatë veprimtarive sindikaliste.

Neni 84

Detyrimet e Policisë ndaj Sindikatës së Policisë

1. Ministri i Brendshëm e lejon kryesinë e përcaktuar në statutin e sindikatës të mblidhet katër herë në vit gjatë orarit të punës.

2. Ministri i Brendshëm e lejon asamblenë e përcaktuar në statutin e sindikatës të mblidhet një herë në vit gjatë orarit të punës.

3. Marrëdhëniet ndërmjet sindikatës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë rregullohen me marrëveshje dypalëshe.

(Vijon në faqen 29)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 28)

KREU V

TRAJTIMI I PERSONELIT

Neni 85

Rregullat dhe procedurat për marrëdhëniet e punës, trajnimin, ecurisë në karrierë dhe ndërprerjes së saj, përcaktohen në rregulloren e personelit, në zbatim të këtij ligji, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 86

Koha e punës dhe e pushimit

1. Koha e punës dhe e pushimit për punonjësit e Policisë njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës publike, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Pushimi vjetor i pagueshëm për punonjësit e Policisë është 30 deri në 45 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar, sipas klasave dhe gradave.

3. Kur për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt bëhet kompensimi në vlerë, sikurse edhe p, r orët shtesë të punës dhe të shërbimit.

4. Në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore apo të gatishmërisë, koha deri në 24 orë, mbi kohën normale të punës e të shërbimit, brenda 6 muajve, nuk trajtohet si orë shtesë pune.

5. Në rast fatkeqësie familjare, martesë apo në raste të tjera të veçanta, punonjësit të Policisë i jepet deri në 7 ditë leje e pagueshme ose deri në 2 muaj leje pa të drejtë pagese.

Periudha e lejes pa të drejtë pagese nuk llogaritet në vjetërsi pune e shërbimi dhe as për efekte të ecurisë në karrierë.

6. Kriteret dhe masat e përfitimeve përcaktohen me akt të veçantë normativ të Këshillit të Ministrave.

Neni 87

Rregullimi i pagave

1. Për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë, punonjësi i Policisë ka përparësi në trajtimin me pagë.

2. Paga e punonjësit të Policisë caktohet sipas gradës dhe funksionit, që ka fituar.

3. Paga mujore e punonjësit të Policisë përbëhet nga paga bazë, që është paga për gradë, dhe nga shtesat mbi pagën bazë (në përqindje ose në shumë absolute) për kushte të tjera të veçanta të vendit të punës e të shërbimit, përfshirë profesionin, kualifikimin dhe p, rvoj, n dhe për kompensim të privacioneve dhe humbjeve, që i krijohen punonjësit të Policisë, për shkak të nevojave të punës e të shërbimit.

4. Punonjësi i Policisë përfiton edhe të gjitha shtesat e tjera të veçanta mbi pagë si dhe shpërblimet, që përfitojnë punonjësit e tjerë të administratës publike.

5. Punonjësit e Policisë përfitojnë, çdo vit, në fund të vitit financiar, një shpërblim, deri në një pagë mujore, të njëjtë me atë të përfituar nga punonjësit civilë

dhe punonjësit e tjerë të administratës shtetërore. Ky shpërblim jepet në bazë të një shkalle përpjestueshmërie, që pasqyron kohën e punës së kryer nga punonjësi gjatë vitit financiar. Punonjësit, që nuk kanë mundësi në punë për çfarëdo arsye, përveç kohës së pushimit, kanë të drejtën e shpërblimit të plotë. Kjo pagë nuk përfitohet në rastet kur punonjësi është ndëshkuar me masën “Largim nga Policia”.

6. Rregullimi i pagave, kriteret dhe përgjegjësitë për dhënien e tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 88

Dhënia e pensionit dhe e përfitimeve suplementare

Punonjësi i Policisë, përveç përfitimeve, që rrjedhin nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve dhe kriterëve, të përcaktuara në ligjin nr. 8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Neni 89

Përparësia për rikthim në shërbim

Punonjësi i Policisë, që gjendet në pagesë kalimtare dhe që plotëson kushtet dhe kriteret për të vazhduar karrierën policore, nëse ajo është ndërprerë, në çdo rast ka përparësi për t’u rikthyer në shërbim, brenda një viti nga çasti që fiton pagesën kalimtare, në raport me kandidaturat e tjera, që mund të paraqiten për një funksion të caktuar, sipas gradës, që mban apo që i takon.

Neni 90

Baza e të dhënave të shenjave të gishtave dhe ADN-së së punonjësve të Policisë

1. Shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së e të gjithë punonjësve të Policisë do të ruhen në një bazë të dhënash, në laboratorin e policisë shkencore, për të përjashtuar të dhënat e tyre nga ato të proceseve. Ruajtja e të dhënave do t’i shërbejë procesit të rekrutimit për ata që do të aplikojnë për t’u pranuar në Policinë e Shtetit dhe këto të dhëna do të merren nga të gjithë punonjësit në shërbim, nëse ato nuk janë marrë në çastin e marrjes në punë.

2. Shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së së marrë, për të krijuar këtë bazë të dhënash, do të shkatërrohen, qoftë në letër apo formë elektronike, kur një punonjës policie del në pension, lirohet apo largohet nga Policia.

3. Nëse një punonjës policie rikthehet, shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së do të rimerren.

PJESA E KATËRT

KOMPETENCAT E POLICISË

KREU I

MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE TË SIGURISË PUBLIKE

(Vijon në faqen 30)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 29)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 91

Detyrat

1. Në zbatim të përgjegjësisë të përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji, punonjësit e Policisë kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) duhet të shmangin në të gjitha rastet rrezikun, për shtetasit dhe veten, sipas këtij rendi.

b) në rastet kur punonjësit e Policisë vlerësojnë se ka nevojë për marrjen e masave shtesë ose nevojitet ndihmë, duhet, menjëherë, të njoftojnë autoritetet përgjegjëse administrative dhe t'i këshillojnë ato për masat e mundshme.

Neni 92

Proporcionaliteti

1. Masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë dhe ajo nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur.

2. Masa mbetet e përshtatshme edhe nëse ajo ul masën e rrezikut ose e pakëson atë përkohësisht. Nëse masa është e paefektshme, atëherë mund të zgjidhet një masë tjetër me ndikim më të madh.

Neni 93

Ndërprerja e masave

Zbatimi i mëtejshëm i çdo mase të ndërmarrë ndërpritet, menjëherë, kur shkak i saj nuk ekziston më.

Neni 94

Ekzekutimi i menjëhershëm

1. Ekzekutimi i menjëhershëm i masës mund të merret vetëm nëse duhet menjëherë një rrezik real dhe i çastit për sigurinë dhe rendin publik, i cili nuk mund të shmanget me anë të mjeteve të tjera.

2. Personi, ndaj të cilit ndërmerret masa, duhet të njoftohet menjëherë për masën e marrë.

3. Autoritetet mund të kërkojnë me një akt administrativ që kostoja për ekzekutimin e menjëhershëm të rifinancohet, nga ata persona, që janë përgjegjës, sipas neneve 96 dhe 97.

Neni 95

Masat për ruajtjen e rendit

1. Kur sjellja e një personi cenon rendin dhe sigurinë publike, ndaj tij merret masë.

2. Nëse cenimi i rendit dhe i sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një subjekti të mitur nën 14 vjeç, përveç masave të marra ndaj tij, punonjësi i Policisë njofton prindin ose kujdestarin e të miturit nën 14 vjeç, për ndërprerjen e veprimeve të paligjshme të të miturit.

Neni 96

Përgjegjësia për gjendjen e objekteve

Kur siguria dhe rendi publik rrezikohen ose cenohen nga gjendja e një objekti, masa mund të merret ndaj pronarit të objektit. Masa mund të jepet edhe ndaj personit, që sillet si pronar i objektit.

Neni 97

Masat ndaj palëve të treta

1. Masat mund të merren ndaj personave, që nuk përfshihen në nenet 95 dhe 96, në qoftë se rreziku real dhe i çastit për sigurinë dhe rendin publik ose cenimi i sigurisë dhe i rendit publik nuk mund të shmangen dhe për sa kohë që punonjësi përkatës i Policisë nuk ka personelin dhe mjetet e duhura.

2. Sipas kushteve paraprake të pikës 1, të këtij neni, punonjësit e Policisë, në mënyrë të veçantë, mund të detyrojnë një person të japë ndihmë fizike. Ata, gjithashtu, mund të marrin, përkohësisht, në posedim objekte të tilla si mjedise akomodimi, medikamente dhe ushqim, mjete pune, materiale ndërtimi dhe mjete transporti.

3. Në çdo rast të thirrjes ose bashkëpunimit vullnetar të një personi apo pale të tretë për ndihmë, për përdorim të mjediseve, mjeteve, objekteve, sendeve apo konsumit të mallrave dhe materialeve të tyre, bëhet kompensimi, fizik ose monetar.

4. Lloji dhe masa e kompensimit përcaktohen, duke mbajtur parasysh përgjegjësinë e palëve dhe përfitimin nga shërbimi i ofruar, në përputhje me Kodin Civil, dhe miratohen nga titullari i organit përkatës administrativ.

5. Kur i interesuari nuk bie dakord me llojin dhe masën e kompensimit, ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

6. Pretendimi për kompensim, sipas këtij neni, duhet të paraqitet jo më vonë se 30 ditë nga data e lindjes së kësaj të drejte, dhe të realizohet jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së kërkesës. Me mbarimin e këtij afati, i interesuari ka të drejtë që, në rrugë gjyqësore, të kërkojë edhe kompensimin për kamatëvonesat ose fitimin e munguar.

Neni 98

E drejta e individit për të ndihmuar Policinë

1. Çdo individ mund të ndihmojë Policinë në kryerjen e detyrave, të përcaktuara në ligj.

2. Nëse gjatë ndihmës, që i jep Policisë, individit plagoset, sëmuret apo humbet aftësitë e tij për punë, ai ka të drejtë të përfitojë çdo ndihmë mjekësore, pension, pagesë për paaftësi në punë dhe pagesë në rast vdekjeje, përfitime të cilat i takojnë një punonjësi policie në rast aksidenti në punë. Kjo pagesë është në përpjesëtim me pagesën e fundit vjetore të punonjësit të Policisë, sipas gradës që ai mban.

KREU II

MASAT SPECIALE

Neni 99

Njoftimi për paraqitje në Polici

1. Punonjësi i Policisë njofton individë për t'u paraqitur në zyrat e Policisë, në këto raste:

a) Për të marrë informacion për parandalimin e një rreziku;

(Vijon në faqen 31)

PROJEKTLIGJE NË PROCES **Projektligji “Për Policinë e Shtetit”**

(Vijon nga faqja 30)

- b) Për të identifikuar personat, që mund të kenë dijeni për rrezikun apo incidentin;
- c) Për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit;
- ç) Për të identifikuar personin.

2. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletënjoftimit ose edhe verbalisht, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, punonjësën e Policisë, kohën, vendin dhe informacion për të kontaktuar punonjësën e Policisë në rast pamundësie për t'u paraqitur.

3. Kur për shkak të kushteve, personale dhe familjare, personi që njoftohet nuk mund të paraqitet në zyrat e Policisë, punonjësi i Policisë mund të shkojë ta marrë këtë informacion në vendbanimin e personit të njoftuar.

Neni 100

Shoqërimi në Polici

1. Punonjësi i Policisë bën shoqërimin e personave në zyrat e Policisë ose organin urdhërdhënës, vetëm në rastet dhe në kushtet e parashikuara në nenet 27 e 28, të Kushtetutës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Personat e shoqëruar, të cilët nuk dyshohen se kanë kryer një veprë penale, mbahen në mjedise të ndryshme nga ato të personave, të ndaluar ose të arrestuar. Në këto raste mbajtja e personave në Polici nuk duhet të zgjasë më shumë se 10 orë.

3. Për rastet e shoqërimeve për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimet ose ekstradimet, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për shoqërimin dhe mbajtjen e personave në zyrat e Policisë, punonjësi i Policisë bën dokumentimin e veprimit dhe njofton menjëherë eprorin e vet ose organin e interesuar për sqarimin e çështjes.

5. Në të gjitha rastet e shoqërimit dhe mbajtjes në zyrat e Policisë, merren parasysh kushtet, personale dhe familjare, të personit që shoqërohet.

Neni 101

Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i Policisë bën kontrollin e identitetit të personave kur:

- a) janë të pranishëm ose në afërsi të drejtëpërdrejtë me vendngjarjen dhe kur janë dëshmitarë të mundshëm të veprës penale;
- b) ekzekutohet një urdhër i organeve përkatëse;
- c) kërkohen personat e dyshuar për cenim të rendit publik;
- ç) hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë;
- d) për rrethana të kohës dhe vendit, dyshohet se personi është përfshirë në veprime të jashtëligjshme.

2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i Policisë bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit.

Neni 102

Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit

Për të regjistruar, nga ana administrative, të dhënat e personave të arrestuar, të ndaluar ose të shoqëruar, Policia kryen këto veprime:

1. Në rast shoqërimi Policia evidenton, për çdo person të shoqëruar, të dhënat për:

- a) gjenealogjet;
 - b) vendbanimin;
 - c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë të dhëna të veçanta;
 - ç) punën që kryen;
 - d) arsyet e shoqërimit;
 - dh) datën dhe vendin e shoqërimit;
 - e) zyrën e Policisë ku është kryer shoqërimi;
 - ë) punonjësën e Policisë, i cili ka kryer shoqërimin.
- Këto të dhëna do të ruhen për shtatë vjet.

2. Në rast arrestimi apo ndalimi, Policia evidenton, për çdo person të arrestuar apo të ndaluar, të dhënat për:

- a) gjenealogjet;
- b) vendbanimin;
- c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë të dhëna të veçanta;
- ç) punën që kryen;
- d) veprën penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar;
- dh) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar ;
- e) datën dhe vendin e arrestimit apo ndalimit;
- ë) zyrën e policisë, ku është mbajtur;
- f) punonjësën e Policisë, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin.

3. Nga çdo person, i arrestuar apo i ndaluar, në çdo rast, policia merr të dhënat e mëposhtme:

- a) shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;
- b) dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil;
- c) mostrën për analizën e ADN-së, kur ekzistojnë kushtet teknike për konservimin dhe administrimin e kam pionëve .

4. Punonjësi i Policisë, me gradë nënkomisar apo më lart, ose në rast emergjence dhe në mungesë të një punonjësi të tillë të Policisë, punonjësi me gradën më të lartë mund të autorizojë përdorimin e forcës së arsyeshme për të realizuar kërkesat, sipas pikës 3, të këtij neni, nëse personi i arrestuar apo i ndaluar kundërshton kërkesën.

5. Policia mund të marrë nga çdo person i shoqëruar të dhënat identifikuese, të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, nëse këto të dhëna nevojiten për të përcaktuar identitetin e personit. Nëse personi i shoqëruar nuk arrestohet apo ndalohet, të dhënat identifikuese

(Vijon në faqen 32)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 31)

të marra duhet të eliminohen pasi të përcaktohet identiteti i tij.

6. Punonjësit e Policisë, të caktuar me detyrë në pikat e kalimit kufitar, mund të marrin shenjat e gjurmëve të gishtave për qëllime identifikimi nga çdo person, që kalon kufirin, kur ata mendojnë se hyrja ose dalja e këtij personi nga territori i Republikës së Shqipërisë përbën shkelje administrative ose kryerje të një veprë penale. Nëse ky person nuk arrestohet apo ndalohet, të dhënat identifikuese, të marra, duhet të eliminohen pasi të përcaktohet identiteti i tij.

7. Për të gjithë personat e arrestuar apo të ndaluar, Policia e Shtetit krijon një bankë qendrore me të gjitha të dhënat e mbledhura sipas pikës 2, të këtij neni, dhe me të gjitha shenjat e gishtave, fotografitë dhe ADN-në, të marra sipas pikës 3, të këtij neni.

8. Një person i arrestuar apo i ndaluar, i cili jep të dhënat e identitetit, të përcaktuara në pikën 3, dhe që më pas lihet i lirë apo shpallet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, ose pushohet procedimi penal në nqarkim të tij për veprën, për të cilën u arrestua apo u ndalua, mund t'i bëjë kërkesë me shkrim drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që të dhënat e tij identifikuese të eliminohen.

Neni 103

Largimi nga vendndodhja

Për të shmangur kërcënimin ose shqetësimin për rendin ose sigurinë publike, punonjësi i Policisë mund të urdhërojë personin të largohet nga vendndodhja ose mund ta ndalojë atë të hyjë në një mjedis, për aq kohë sa ky kërcënim apo shqetësim vazhdon.

Neni 104

Bllokimi i rrugëve

Për nevoja të rendit e të sigurisë publike dhe të zbatimit të ligjit, ose në rastet e fatkeqësive natyrore apo të aksidenteve, punonjësit e Policisë bllokojnë pjesë të rrugëve ose të mjediseve publike, deri në kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore.

Neni 105

Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse. Në këto raste punonjësi i Policisë e shoqëron personin në mjediset e policisë, në institucionet shëndetësore, qendrat e rehabilitimit apo e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.

3. Punonjësit e Policisë marrin masat e nevojshme për mbrojtjen e:

a) personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe, për këtë arsye, mund t'i shkaktojë dëmtime fizike apo rrezikim të jetës së tij apo të të tjerëve. Zbatimi i masës në mjediset e Policisë vazhdon për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 10 orë.

b) të miturit, që nuk mbikëqyret më ose është larguar nga prindi apo kujdestari i tij, duke ia rikthyer kujdestarit apo duke e dërguar në qendrat e përkujdesit për të miturit, sipas afatit të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni.

3. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, punonjësi i Policisë mund të bëjë kontrollin dhe këqyrjen fizike të këtyre personave.

Neni 106

Trajtimi i të shoqëruarve

1. Nëse një person shoqërohet sipas nenit 100, atëherë ai duhet të njoftohet menjëherë për arsyet e shoqërimit.

2. Personit të shoqëruar duhet t'i jepet menjëherë mundësia për të njoftuar një të afërm ose një person, të cilit ai i beson. Nëse i shoqëruari nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tij si më sipër dhe nëse nuk bie ndesh me vullnetin e personit, Policia njofton kryesisht personat e sipërpërmendur. Kur i shoqëruari është i mitur, atëherë, në çdo rast, njoftohet menjëherë, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e tij. E njëjta gjë vlen edhe për të rriturit, për të cilët është caktuar një kujdestar.

3. Femrat dhe meshkujt shoqërohen në mjedise të veçuara. Të miturit shoqërohen në mjedise të veçanta nga ato të të rriturve.

Neni 107

Bllokimi i sendeve

1. Sendet bllokohen ose sekuestrohen vetëm në rastet kur lejohet me ligj dhe në përputhje me procedurat përkatëse ligjore.

2. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krenjtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimin t, çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike. Punonjësi i Policisë, që vepron, harton procesverbalin e caktuar, i cili i jepet poseduesit nëse ai njihet.

3. Sendet bllokohen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme. Pas kësaj, sendet i kthehen poseduesit nëse është identifikuar ose nëse identifikohet pa vonesë. Nëse brenda 90 ditëve, ose në një hark kohor më të shkurtër, siç mund ta kërkojë natyra e sendit, poseduesi i sendit nuk mund të identifikohet ose nuk kërkon me dëshirën e tij kthimin e sendit, sendi i bllokuar kalon në pronësi të shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Policia ka përgjegjësinë të kryejë kontrolle për identifikimin e pronarit të sendeve të bllokuara.

Neni 108

Kontrolli i personit

1. Punonjësi i Policisë mund të kontrollojë çdo person të arrestuar, të ndaluar apo të shoqëruar, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe me legjislacionin në fuqi:

(Vijon në faqen 33)

PROJEKTLIGJE NË PROCES Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 32)

a) për të siguruar prova për kryerjen e veprës penale;
b) për objekte ose sende që mund të rrezikojnë jetën e tij ose të tjerëve.

2. Kontrolli kryhet në tri forma:

a) Kontrolli në publik i rrobave të trupit të një personi, i cili kufizohet në një kontroll sipërfaqësor të veshjeve të jashtme;

b) Kontrolli i imët kryhet në vende të caktuara, që nuk shihen nga publiku, ku personi i ndaluar nuk shihet nga persona të tjerë dhe përfshin heqjen e më shumë se veshjeve të jashtme;

c) Kontrolli intim i cili ka të bëjë me këqyrjen fizike të pjesëve të hapura në trupin e personit dhe kryhet nga punonjës së shëndetësisë dhe vetëm në spitale, në mjedise të tjera shëndetësore.

3. Kontrollat sipas shkronjës “a”, të pikës 2, kryhen nga punonjës policie të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar, kur e lejojnë rrethanat. Për kontrollin e të miturve kërkohet edhe prania e prindit ose e kujdestarit.

4. Punonjësi i Policisë mund të kryejë kontrollin e çdo personi sipas shkronjës “a”, të pikës 2, përveç personave, të cilëve ligji u njeh imunitet, kur ai beson se kontrolli është i nevojshëm për sigurinë e vetë personit ose të çdo personi tjetër.

5. Kontrolli i imët mund të kryhet vetëm nëse ai vlerësohet i nevojshëm për të hequr sendin e ndaluar dhe punonjësi i Policisë gjykon se personi, i arrestuar apo i ndaluar, mund ta ketë fshehur atë. Ky kontroll kryhet nga një punonjës policie i së njëjtës gjini me personin e kontrolluar.

6. Kontrolli intim kryhet me autorizimin e prokurorit. Kontrolli intim ndërmerret si masë e fundit ndaj personit që dyshohet se fsheh prova materiale të veprës penale ose sende, që i përkasin veprës penale. Kontrolli intim kryhet vetëm nga një mjek ose infermier i kualifikuar.

7. Rregullat e hollësishme për kryerjen e kontrollit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 109

Kontrolli mjekësor i personit

1. Për të parandaluar kërcënimin për jetën, një personi mund t'i bëhet kontroll mjekësor. Për këtë arsye marrja e kampionëve të gjakut ose ndërhyrje të tjera në trup nga një mjek, në përputhje me rregullat mjekësore, për qëllime ekzaminimi, lejohet pa miratimin e personit, nëse kjo nuk dëmton shëndetin e tij dhe masa vlerësohet e nevojshme nga mjeku.

2. Kontrolli mjekësor i personit bëhet me vendim gjykate, me përjashtim të rasteve të kërcënimit të menjëhershëm. Të dhënat e mbledhura gjatë kontrollit mund të përdoren vetëm për qëllimin e këtij neni, që është parandalimi i rrezikut serioz për shëndetin.

Neni 110

Kontrolli i objekteve

1. Një objekt mund të kontrollohet nëse:

a) zotërohet nga një person, që është kontrolluar sipas nenit 112;

b) faktet bëjnë të dyshohet se brenda objektit ndodhet një person:

i) i cili duhet të arrestohet ose ndalohet;

ii) i cili mbajtur në mënyrë të jashtëligjshme;

iii) për të cilin punonjësi i Policisë ka dyshime të bazuara se kontrolli është i nevojshëm për mbrojtjen e jetës nga një rrezik i çastit.

c) faktet bëjnë të dyshohet se aty ndodhet një send tjetër, që mund të konfiskohet.

2. Kontrollohet një automjet, që ka brenda një person, identiteti i të cilit mund të verifikohet në një pikë kontrolli. Kur ekziston njëra nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kontrolli mund të bëhet edhe ndaj sendeve brenda automjetit.

3. Përdoruesi i objektit ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë kontrollit të tyre. Nëse ai nuk paraqitet, ftohet një përfaqësues apo dëshmitar tjetër. Përdoruesit duhet t'i dorëzohet një kopje e procesverbalit të kontrollit dhe arsyet, nëse kërkohen prej tij.

Neni 111

Hyrja dhe kontrolli i mjediseve

1. Mjedise, në kuptim të këtij ligji, quhen banesa dhe dhomat ngjitur, dhomat e punës, mjediset e veprimtarive profesionale, si dhe çdo pronë tjetër private, që lidhet me këto dhoma.

2. Hyrja dhe kontrolli në mjedise mund të bëhen pa lejen e pronarit nëse:

a) është e nevojshme të parandalohet një kërcënim i çastit për jetën dhe shëndetin;

b) një punonjës policie ka arsye të bazuara të mendojë se një person, i cili plotëson kushtet e nenit 105, ndodhet në atë mjedis.

3. Nëse pronari apo personi, që zotëron mjedis ose përfaqësuesi i tij nuk janë të pranishëm gjatë kontrollit, duhen njoftuar, menjëherë, për arsyen e kontrollit, për sa kohë që qëllimi i masës së marrë nuk vihet në rrezik.

4. Në të gjitha rastet e hyrjeve dhe të kontroleve sipas këtij neni, punonjësi i Policisë harton një raport, ku përmenden arsyet e hyrjes dhe të kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij. Një kopje e këtij raporti i jepet, sipas kërkesës, personit të interesuar ose personave të autorizuar prej tij.

Neni 112

Kontrolli antiterrorist

1. Punonjësit e Policisë kryejnë kontrole për parandalimin e akteve terroriste kundër banesave, ndërtesave, mjediseve dhe hapësirave publike, për të garantuar sigurinë e personave dhe të rendit kushtetues, kombëtar dhe ndërkombëtar.

(Vijon në faqen 34)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 33)

2. Kontrolli antiterrorist përfshin kontrollin për eksplozivë, kontrollin kimik, biologjik dhe radioaktiv.

Neni 113

Mbledhja e të dhënave

1. Punonjësi i Policisë ka përgjegjësi të mbledhë të dhëna për nevoja të mbrojtjes së rendit e të sigurisë publike dhe/ose për parandalimin dhe zbulimin e krimeve, duke shfrytëzuar çdo burim, që mund të jap, të dhëna. Për këtë qëllim ai mund të përdorë edhe bashkëpunimin e fshehtë me individë, vëzhgimin e fshehtë të personave dhe mjediseve, si dhe pajisjet gjurmuese të vendndodhjes.

2. Ndalohet marrja e të dhënave për persona vetëm për arsye të tilla si gjinia, etnia, raca, gjuha, feja, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, prirja seksuale apo përkatësia prindërore.

3. Organet e administratës publike, personat, fizikë e juridikë janë të detyruar t'i paraqesin të dhënat identifikuese dhe informacionet e mbledhura në mënyrë të ligjshme, kur u kërkohen nga Policia, përjashtuar të dhënat, shpërndarja e të cilave është e ndaluar me ligj.

4. Rregullat konkrete për përdorimin e burimeve të informacionit, si dhe për marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave, që përfitohen prej tyre, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 114

Bashkëpunimi i fshehtë me individët

1. Punonjësi i Policisë detyrohet të pranojë dhe vlerësojë çdo informacion, që vjen, në mënyrë të fshehtë, nga individë dhe që lidhet me mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe/ose parandalimin e veprave penale.

2. Kur një person vendos marrëdhënie të fshehta bashkëpunimi me Policinë, për të informuar për çështje, që lidhen me mbrojtjen e rendit e të sigurisë publike dhe/ose për parandalimin, zbulimin dhe goditjen e veprave penale, është i detyruar të ruajë sekretin e këtij bashkëpunimi dhe të informacioneve të klasifikuara, deri sa të përfundojë detyrimi ligjor, për ruajtjen e sekretit.

3. Punonjësit e Policisë kanë detyrimin të ruajnë fshehtësinë e identitetit dhe të rrethanave të tjera për personat, që bashkëpunojnë në mënyrë të fshehtë me policinë, nëpërmjet dhënies së informacioneve për mbrojtjen e rendit e të sigurisë publike ose për parandalimin dhe goditjen e veprave penale.

4. Mënyra e administrimit dhe e ruajtjes së fshehtësisë së deklarimeve ose kallëzimeve bëhet sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit procedural penal.

Neni 115

Masa të veçanta

1. Kur në bazë të të dhënave, që disponohen, dyshohet se një person ka kryer një vepër penale ose po

planifikon a po organizon të kryejë një krim, dhe kjo veprimtari nuk mund të zbulohet ose të parandalohet në rrugë e mënyra të tjera, punonjësi i Policisë, me gradën drejtues ose më lart, sipas juridiksionit lëndor, i bën kërkesë prokurorit të marrë njërën nga masat e mëposhtme:

a) Përgjimin e fshehtë të bisedave të një personi, në vende publike;

b) Përgjimin e fshehtë të bisedave telefonike ose telekomunikimeve të një personi, në përputhje me legjislacionin përkatës;

c) Përdorimin e pajisjeve teknike për fotografim, regjistrim audio ose video, në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Përdorimi i masave të veçanta, sipas pikës 1, të këtij neni, lejohen për aq kohë sa ekzistojnë arsyet ose rrethanat, që kanë bërë të nevojshëm përdorimin e tyre dhe zgjasin sipas afateve të vendosura në legjislacionin përkatës.

3. Kur referimi i veprës penale, për të cilën janë përdorur masat e veçanta, nuk bëhet brenda gjashtë muajve, pas përfundimit të përdorimit të masave të veçanta, të parashikuara në këtë nen, i gjithë informacioni i mbledhur, si rezultat i përdorimit të këtyre masave, asgjësohet.

Neni 116

Veprimtaria informative

1. Veprimtaria informative e policisë, në kuptim të këtij ligji, do të vlerësohet procesi i grumbullimit, sistemimit, vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit për nevoja të mbrojtjes së rendit e të sigurisë publike ose për nevoja të parandalimit e zbulimit të veprave penale.

2. Veprimtaria informative e Policisë bazohet vetëm në të dhënat e marra, në përputhje me ligjet përkatëse dhe me aktet normative, të nxjerra në zbatim të tyre.

3. Rregullat konkrete për realizimin e veprimtarisë informative të Policisë prej strukturave përkatëse, si dhe masat për ruajtjen e të dhënave dhe për kontrollin e kësaj veprimtarie informative, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU III

RASTE DHE FORMA TË PËRDORIMIT TË FORCËS

Neni 117

Përdorimi i forcës

1. Përdorimi i forcës mbi personat është veprimi i drejtpërdrejtë, nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve të tjera apo armëve të zjarrit.

2. Punonjësi i Policisë përdor forcën, për të përmbushur një synim të ligjshëm, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Punonjësi i Poli-

(Vijon në faqen 35)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Policinë e Shtetit"

(Vijon nga faqja 34)

cisë përdor nivelin minimal të forcës së nevojshme, në përputhje me parimin e përpjesëtueshmërisë.

3. Punonjësi i Policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës, ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë kimike paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.

4. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.

5. Punonjësi i Policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm, për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

6. Grupe personash duhen paralajmëruar sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose se forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen.

Neni 118

Përdorimi i armëve të zjarrit

Punonjësi i Policisë përdor armët e zjarrit, që ka në përdorim, në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin përkatës, që rregullon përdorimin e armëve të zjarrit.

Neni 119

Masat e detyrueshme mjekësore

Masat mjekësore, të ndërmarra ndaj personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i tyre do të bëhen sipas rregullave dhe kushteve, të përcaktuara në aktet përkatëse normative.

Neni 120

Kryerja e operacioneve speciale

1. Për kryerjen e operacioneve të sigurisë së veçantë dhe zgjidhjen e situatave, të cilat nuk mund të përballohen nga shërbimet e tjera të Policisë, përdoren struktura speciale operacionale, rezervë e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

2. Përgjegjësitë e këtyre strukturave janë:

- çlirimi ose shpëtimi i pengjeve;
- kapja e personave të armatosur, me rrezikshmëri të lartë, dhe transportimi i tyre në mjediset e Policisë;
- mbështetja e strukturave, të cilat sigurojnë personalitetet e larta shtetërore, të vendit ose të huaja, në rastet kur ka të dhëna për akte terroriste ndaj tyre;
- rivendosja e rendit dhe e sigurisë publike, kur kjo është e pamundur, vetëm me strukturat e tjera policore.

3. Punonjësve të strukturave speciale operacionale u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale.

4. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të strukturave speciale operacionale, si dhe procedurat, rregullat dhe kriteret e përdorimit të tyre përcaktohen me urdhër të ministrit.

PJESA E PESTË

ZGJEDHJET

Neni 121

Përfshirja e punonjësve të Policisë gjatë zgjedhjeve

1. Punonjësit e Policisë janë të detyruar të veprojnë, në përputhje me këtë kre dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

2. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara me hollësi në Kodin Zgjedhor, të gjithë punonjësit e Policisë, me uniformë, me përjashtim të strukturave speciale operacionale, kanë atributet e punonjësit të Policisë së Rendit Publik.

3. Përdorimi i strukturave speciale operacionale dhe punonjësve të policisë, të punësuar në strukturat e krimit të organizuar, antiterrorizmit dhe krimit të hapur, në çfarëdo funksioni, për mbrojtjen e qendrave të votimit, shoqërimit në kutitë e votimit ose mbrojtjen e qendrave të numërimit të votave, është i ndaluar.

4. Jo më vonë se shtatë ditë nga data e zgjedhjeve, drejtori i Përgjithshëm i Policisë i jep komisionit qendror të votimit një listë të plotë të punonjësve të caktuar me detyra për zgjedhjet.

5. Për çdo punonjës, që ka emrin në listë, krahas të dhënave personale (emrit dhe gradës) do të jepen edhe detyrat e punonjësit, vendi i punës, emri i eprorit të drejtpërdrejtë dhe, në mënyrë të hollësishme, të gjitha detyrat e tij.

6. Drejtori i Përgjithshëm është i detyruar të njoftojë, çdo ditë, për ndryshimet, që i bëhen kësaj liste para datës së zgjedhjeve.

7. Drejtori i Përgjithshëm është i detyruar t'i japë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kopje të të gjitha urdhërave të nxjerra gjatë periudhës së zgjedhjeve, që kanë të bëjnë me të gjitha veprimtaritë, e Policisë për zgjedhjet.

8. Garda e Republikës mbron objektet dhe personalitetet, që i janë caktuar gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Neni 122

Mbajtja e armës nga Policia gjatë zgjedhjeve

1. Punonjësi i Policisë, i nqarkuar me detyra, që lidhen me zgjedhjet, përveç atyre të përcaktuara në pikun 2, të këtij neni, mban vetëm armë brezi (pistoletë).

2. Krahas armës personale në brez, punonjësi i Policisë, që ka për detyrë të mbrojtë qendrën e votimit, gjatë natës përpara votimit mban armë të gjatë (pushkë).

Neni 123

Karta identifikuese

(Vijon në faqen 36)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 35)

Çdo punonjës i Policisë, i nqarkuar me detyra që lidhen me zgjedhjet, do të mbajë në publik, gjatë gjithë periudhës së zgjedhjeve, kartë identifikuese, forma dhe përmbajtja e së cilës përcaktohen nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

PJESA E GJASHTË **TË NDRYSHME**

Neni 124

Policimi në komunitet

1. Çdo drejtor i drejtorive të policisë në qarqe harton një strategji vjetore të policimit në qark për sigurinë në komunitet pas këshillimeve me personat e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni.

2. Personat e specifikuar për qëllimet e pikës 1, janë:

- a) prefekti, i cili ushtron funksionet në qarkun, që mbikëqyret nga drejtori i policisë së qarkut;

- b) kryetari i bashkisë dhe drejtues të pushtetit vendor, të cilët ushtrjnë funksione në policinë e qarkut, që mbikëqyret nga drejtori i policisë së qarkut;

- c) përfaqësues nga drejtoritë e institucioneve të qarkut;

- ç) përfaqësues nga grupet e interesit.

3. Strategjia vjetore e policimit në qark, e hartuar në përputhje me pikën 1, të këtij neni, duhet:

- a) të identifikojë konfigurimin e veprave penale dhe të shkeljeve të tjera të ligjit, të cilat janë më të përhapura në qarkun përkatës të policisë;

- b) të propozojë rekomandime për uljen e nivelit të veprave penale dhe të shkeljeve të ligjit në qark dhe të shprehë qartë angazhimin, për të bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme, me përfaqësues të komunitetit;

- c) të identifikojë mënyrat si janë trajtuar shqetësimet e ngritura nga përfaqësuesit e komunitetit gjatë 12 muajve të kaluar.

4. Drejtori i drejtorisë së policisë së qarkut duhet të paraqesë strategjinë vjetore për të cilën ai është përgjegjës te drejtori i Përgjithshëm i Policisë, kur paraqet raportin, sipas pikës 3, të nenit 29, si dhe te kryetarët e bashkive të qarkut.

5. Strategjia e policisë në nivel qarku, së bashku me raportin sipas pikës 3, të nenit 29, i dorëzohet për miratim grupit të përbashkët të politikave në takimin e tij të muajit janar.

Neni 125

Përpunimi i të dhënave personale

1. Mbledhja, ruajtja, përdorimi dhe komunikimi i të dhënave personale për qëllime të Policisë kufizohet vetëm me nevojat operacionale, kur janë të nevojshme për parandalimin e rrezikut real ose parandalimin e një vepre penale. Gjatë përpunimit të të dhënave respektohen parimet dhe rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Europës në konventë “Për mbrojtjen e individëve për përpunimin automatik të të dhënave personale”, 28 janar 1981, ratifikuar me

ligjet nr.9288, datë 7.10.2004 dhe nr.8792 të datës 10.10.2001, “Për krijimin e qendrës së përpunimit të të dhënave”.

2. Të dhënat mund t’u komunikohen agjencive të huaja policore vetëm në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi, në të cilën struktura e policisë, që e kërkon, merr përsipër detyrimin se do t’i trajtojë dhe ruajë në përputhje me legjislacionin në fuqi duke siguruar një shkallë të caktuar të mbrojtjes të së dhënave të barabartë ose në nivel më të lartë nga ajo që garantohet në ligjet e sipërpërmendura.

Neni 126

Medaljet e nderit dhe certifikatat

1. Ministri jep medalje nderi për punonjës të Policisë, punonjës të shërbimeve mbështetëse dhe punonjës policie, të huaj, të atashuar në vendin tonë, kur ata shquhen për merita të veçanta.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe zëvendësit e tij japin certifikata lavdërimi për punonjës të Policisë, të dalluar në zbatimin e detyrave.

Neni 127

Llojet e medaljeve dhe të certifikatave

1. Ministri jep këto medalje: “Medalja e Nderit”, “Medalja për Trimëri” dhe “Medalja për Shpëtim Jetë”.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë jep këto certifikata lavdërimi: “Certifikatë për shërbime të dalluara”, “Certifikata e karrierës”, si dhe “Certifikatë për rezultate në sigurimin e rendit rublik”.

3. Motivimi, rregullat dhe procedurat për dhënien e medaljeve, forma e tyre dhe shpërblimi financiar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Llojet e certifikatave të lavdërimit, kriteret dhe procedurat për dhënien e tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme të Policisë.

PJESA E SHTATË

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 128

Kalimi në sistemin e ri të gradave

1. Për kalimin nga sistemi i gradave të dhëna sipas ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 “Për gradat, në Policinë e Shtetit”, në sistemin e gradave sipas këtij ligji, Këshilli i Ministrave nxjerr vendim për përcaktimin e tabelës së funksioneve korresponduese, për çdo gradë, si dhe ekuivalentimin e tyre, në bazë të nenit 38, të këtij ligji.

2. Punonjësi i Policisë merr gradën, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse ka minimalisht 2/3 e vjetërsisë së shërbimit, llogaritur sipas afateve të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 40, të këtij ligji.

- a) Punonjësit të Policisë, që nuk plotëson vjetërsinë për gradën që i korrespondon funksionit që kryen në çastin e kalimit, i jepet grada më e lartë për të cilën ai plotëson minimumi 2/3 e vjetërsisë së shërbimit, duke e emëruar në një funksion, që i korrespondon gradës që merr.

(Vijon në faqen 37)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Policinë e Shtetit”

(Vijon nga faqja 36)

b) Në vjetërsinë e shërbimit, për efekt të marrjes së gradës, në çastin e kalimit, punonjësit të Policisë do t'i llogariten:

i) koha e punës si ushtarak në strukturat e Policisë së kufirit dhe të Gardës së Republikës, kur ato ishin pjesë e Forcave të Armatosura;

ii) koha e punës me statusin e punonjësit të Gardës së Republikës;

iii) koha e punës si punonjës policie në strukturat e Policisë së Shtetit;

iv) koha e punës në strukturat e Ministrisë së Brendshme ose të Ministrisë së Rendit Publik, si punonjës me status policor;

v) koha e punës në strukturat e administratës publike, me cilësinë e këshilltarit për probleme të rendit dhe sigurisë publike;

vi) periudha që punonjësi i Policisë ka punuar si ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm, si dhe gjysma e periudhës që punonjësit e administratës shtetërore kanë punuar jashtë strukturave të përcaktuara në nënndarjet “i”, “ii”, “iii”, “iv”, “v”, të kësaj shkronje.

c) Në rast se punonjësi i Policisë nuk pranon të marrë gradën e dhënë sipas këtij ligji, lirohet nga Policia me gradën, që ka mbajtur sipas ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”.

3. Afatet e qëndrimit në gradë, për efekt të konkurrencimit, për ecje në karrierë të punonjësit të Policisë, pas kalimit në sistemin e gradave sipas këtij ligji, do të llogariten si më poshtë:

a) nga data e marrjes së gradës sipas ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, kur grada e marrë nga punonjësi i Policisë në çastin e kalimit dhe ajo paraardhëse, është ekuivalente ose më e ulët;

b) nga data e marrjes së gradës në çastin e kalimit, kur punonjësi i Policisë merr gradë më të lartë se ajo ekuivalente, që ka mbajtur sipas ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”.

4. Për realizimin e procesit të kalimit në sistemin e gradave sipas këtij ligji, ngrihen komisione kalimtare, të cilat shqyrtojnë dokumentacionin dhe u propozojnë autoriteteve, që e kanë kompetencë gradimin, dhënien e gradave përkatëse punonjësve të Policisë.

5. Përbërja e komisioneve kalimtare, mënyra dhe nivelet e organizimit, të funksionimit, si dhe procedurat që ndjekin këto komisione, përcaktohen me urdhër të ministrit. Këto komisione përfundojnë së funksionuari pas realizimit të procesit të kalimit në këtë sistem gradash.

6. Kalimi në këtë sistem gradash përfundon jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të dalë në zbatim të nenit 38, të këtij ligji.

7. Punonjësi i Policisë ka të drejtë që, brenda 30 ditëve nga marrja dijani, të ankohet për gradën e marrë tek

epriori i autoritetit, që i ka dhënë gradën, ose drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 129

Trajtimi i personelit

Trajtimi, ekonomik e financiar, i punonjësve të Policisë, në karrierë dhe pas ndërprerjes së saj, deri në miratimin e akteve normative përkatëse, të parashikuara në këtë ligj, bëhet sipas dispozitave të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të akteve normative, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

Neni 130

Shfuqizimi i akteve

Ligjet nr. 8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar; nr.8293, datë 26.2.1998, “Për Policinë Kriminale”; nr. 8342, datë 6. 5.1998, “Për Policinë Kufitare”; nr.8292, datë 25. 2.1998, “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”, të ndryshuar; nr.7498, datë 5.7.1991, “Për ruajtjen e rendit e të qetësisë”, të ndryshuar; nr. 8643, datë 20. 7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, si dhe aktet e tjera normative në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e Policisë, por që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 131

Miratimi i akteve normative

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri të nxjerrin aktet normative, në zbatim të këtij ligji, brenda një viti nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 132

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org